

1 E premte, 16 dhjetor 2022

2 [Konferencë për ecurinë e çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hynë në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 10.30

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi  
7 të gjithëve. Mirëserdhët.

8 Për procesverbal, unë jam Charles Smith. Jam  
9 Kryegjykatësi i këtij Trupi Gjykses. Kolegët e mi në të majtë,  
10 Gjykatësi Christoph Barthe; në të djathtë Gjykatësi Guenael  
11 Mettraux; dhe në të djathtën pak më larg, Gjykatësi Fergal  
12 Gaynor.

13 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, kjo është  
15 KSC-BC-2020-06, Prokuroria e Specializuar kundër Hashim  
16 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
18 Ju lutem palëve të prezantohen duke filluar nga Prokuroria e  
19 Specializuar.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëmëngjesi të nderuar Gjykatës.  
21 Nga Prokuroria, Alex Whiting, Ward Ferdinandusse, Nate Quick,  
22 Sarah Clanton, Sebastian van Hooydonk. Dhe unë jam Matt  
23 Halling.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
25 Z. Kehoe, përpara z. Thaçi.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirëmëngjesi, në të djathtë, kam  
2 Sophie Menegon; Bonnie Johnson pak më djathtas; dhe në Zoom  
3 kam bashkëmbrojtësin, Luka Misetiç. President Thaçi është i  
4 pranishëm në sallën e gjyqit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
6 z. Kehoe.

7 Z. Emmerson, ju lutem.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes,  
9 të nderuar Gjykatës. Këtu jam me videolidhje sot për z. Kadri  
10 Veseli, së bashku me ndihmësit që janë në sallën e gjyqit që  
11 janë, z. Andrew Strong, znj. Annie O'Reilly edhe Këshilltari,  
12 z. Hajredin Kuçi.

13 Ju kërkoj ndjesë që nuk jam i pranishëm fizikisht, por  
14 dola me COVID në fakt, kështu që nuk mund të vija.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
16 e morëm vesh këtë dhe ju urojmë shërim sa më të shpejtë.

17 Z. Young, ju do të prezantoni të akuzuarin tjetër.

18 Z. YOUNG: [Përkthim] Sikurse e dini, unë përfaqësoj z.  
19 Rexhep Selimi dhe kam z. Geoffrey Roberts me mua, z. Eric  
20 Tully dhe Dr. Rudina Jasini. Dhe këtu na ndihmon sot znjsh.  
21 Nataliia Ryzhenko, Menaxhere e Çështjes dhe Riva Gjecaaj.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
23 z. Young.

24 Znj. Alagendra, ju lutem.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ju kërkoj

1 ndjesë që nuk mund të jem e pranishme fizikisht. Unë jam  
2 Alagendra Venkateswari dhe përfaqësoj z. Jakup Krasniqi. Po  
3 ashtu me videolidhje, kam z. Aidan Ellis. Të pranishëm në  
4 sallën e gjyqit kemi z. Victor Baiesu; Menaxheren e Çështjes  
5 Eva Jerman; Jacopo Ricci dhe anëtarët që na ndihmojnë z. Durim  
6 Limaj dhe Melissa Gregg [sipas përkthimit].

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
8 Nga përfaqësuesi i viktimave, Simon Laws.

9 Z. LAWS: [Përkthim] Unë jam Simon Laws. Përfaqësoj  
10 viktimat në këtë çështje së bashku me ndihmësen time Maria  
11 Radziejowska.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
13 Edhe mesa kuptoj në fakt z. Nilsson, ju jeni vetëm sot.

14 Z. NILSSON: [Përkthim] Po është e drejtë, vetëm unë jam  
15 sot.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
17 Zyrës Administrative.

18 Tani dua t'ju kujtoj që më 30 nëntor ky Trup Gjykses mori  
19 këtë çështje gjyqësore nga Kryetarja e Dhomave të  
20 Specializuara në përputhje me rregullat 98 dhe 115(1) të  
21 Rregullores së Procedurës dhe Provave pas kalimit të dosjes  
22 gjyqësore që ndodhi vetëm dje. Më 30 nëntor 2022 - më falni,  
23 më falni, ju kërkoj ndjesë. Transferimi u bë dje. Më 30 nëntor  
24 2022, u zgjodha Kryegjykatës i këtij Trupi Gjykses nga  
25 anëtarët e tij.

1 Me qëllim që të mos humbasim kohë për përgatitjen e këtij  
2 gjykimi kemi përfituar në plan afatshkurtër në fakt para se të  
3 bëjmë pushimet e Gjykatës, të bëjmë një Konferencë për Ecurinë  
4 e Çështjes dhe ju falënderoj shumë që erdhët në një njoftim  
5 kaq të shkurtër.

6 Arsyeja kryesore për këtë konferencë është në mënyrë që  
7 të bëjmë planifikimin dhe fillimin e gjykimit pa asnjë vonesë  
8 të panevojshme. Ne nuk duam që të kalojnë tri ditë të pushimit  
9 të Gjykatës pa garantuar që të jenë marrë të gjitha masat e  
10 nevojshme për të garantuar që çështja të kalojë për gjykim sa  
11 më shpejt të jetë e mundshme. Besoj që është në interesin e të  
12 gjithëve që kjo çështje të kalojë në fazën e radhës pa asnjë  
13 vonesë.

14 Pikësëpari, dëshiroj të vlerësoj të gjitha palët për  
15 punën e madhe që kanë bërë dhe pjesëmarrësit gjatë fazës së  
16 procedurës paraprake. Ne e kemi parasysh dhe nuk ka nevojë të  
17 na kujtojë njeri që kjo çështje po hyn në vitin e saj të tretë  
18 dhe të akuzuarit po presin fillimin e gjykimit në paraburgim.

19 Ju të akuzuarit dhe pjesëmarrësit e tjerë të jeni të  
20 sigurt që ky Trup Gjykues do bëjë të pamundur që në mënyrë të  
21 drejtë dhe të shpejtë ta fillojë këtë gjykim pa asnjë vonesë  
22 dhe ta menaxhojë gjykimin në mënyrë efikase dhe në kohën e  
23 duhur. Dëshiroj t'ju jap disa informacione sot, disa udhëzime,  
24 disa urdhra sa u takon afateve strikte, të cilat do të  
25 ndihmojnë planifikimin e deklaratave hyrëse më shpejt dhe të

1 thërrasim dëshmitarët dhe të marrim provat në këtë çështje.

2 Kjo praktikë do të vijojë përgjatë gjithë gjyqimit për të  
3 garantuar që proceset të fokusohen vetëm me çështjet që kanë  
4 lidhje me çështjen gjyqësore dhe që kjo gjykim të ecë me  
5 ritmin e duhur.

6 Pasi lexuam dosjet paragjyqësore të palëve, e kuptojmë që  
7 ka shumë çështje që nuk janë ose të paktën nuk duhet të jenë  
8 ende duke u diskutuar mes palëve. Po ashtu e kemi parasysh  
9 shkallën e bashkëpunimit që duket nga procesverbalet si nga  
10 palët kundërshtare edhe në mes të ekipeve të ndryshme të  
11 Mbrojtjes.

12 Ky Trup Gjyqësor inkurajon bashkëpunimin dhe sigurisht do  
13 të synojë që procedurat të jenë sa më efikase dhe sa më të  
14 shkurtra.

15 Përgjegjësia për të garantuar që i akuzuari të ketë një  
16 gjykim të shpejtë dhe të drejtë është përgjegjësia e të  
17 gjithëve ne, sigurisht në kuadër të mandatit përkatës që ne e  
18 kemi.

19 Tani në seancën e sotme do të vijojmë deri në 12. Do  
20 bëjmë gjysmë ore pushim. Do të mblidhemi në orën 12.30 sërish  
21 dhe do të mbarojmë - shpresojmë në orën 14.00 të pasdites.  
22 Nëse kemi mbaruar dhe para, sigurisht kemi mbaruar më përpara  
23 do ta mbyllim seancën dhe do të rikthehemi për të dhënë disa  
24 urdhra gojorë.

25 Tani paraprakisht në mënyrë që të filloni planifikimin

1 për të ardhmen. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje gjyqësore,  
2 orari në Gjykatë do të jetë siç vijon: Seanca e parë, 09.00  
3 deri në 11.00, seanca e dytë, 11.30 deri në 13.00; seanca e  
4 tretë, 14.30 deri në 16.00. Vetëm nëse nevojitet absolutisht  
5 do ta shtyjmë seancën pas këtij orari.

6 Sigurisht me këtë orar është pak a shumë pesë orë  
7 kohëzgjatja në sallën e gjyqit duke mbajtur parasysh edhe  
8 punën e përkthyesve të shkëlqyer dhe detyrën e vështirë që  
9 kanë ata për të dhënë përkthim simultan që është kaq i  
10 nevojshëm në këtë lloj gjykimesh.

11 Ne shpresojmë të punojmë 20 orë në javë në sallën e  
12 gjyqit.

13 Pikësëpari, duhet të flasim për gjuhën e punës siç është  
14 parashikuar në rregullin 8(3)(a) të Rregullores. Sipas së  
15 cilës, Trupi Gjykses pasi dëgjon palët dhe Mbrojtësen e  
16 Viktimave do të vendosi cila do të jetë gjuha e punës gjatë  
17 gjykimit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vendimin e tij  
18 gjuhët e punës të 11 nëntorit 2020 përcaktoi që gjuha e punës  
19 do të jetë anglishtja për këtë çështje gjyqësore.

20 A janë të gjitha palët dakord që të jetë anglishtja gjuha  
21 e punës për këtë proces penal?

22 Z. Prokuror.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Po.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson.

2 Mikrofonin, ju lutem z. Emmerson.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po, edhe ne  
4 jemi dakord.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Young.

6 Z. YOUNG: [Përkthim] Po.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Alagenda.

9 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po, edhe  
10 ne jemi dakord.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Po, jemi dakord.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani sa i  
14 takon planifikimit të sallës së gjyqit në të ardhmen.

15 Sikurse e dini, kjo sallë gjyqi nuk është vetëm për këtë  
16 çështje gjyqësore. Ka edhe procedura të tjera, të cilat duhet  
17 të kryhen në të njëjtën sallë gjyqi sikurse edhe rasti ynë. Ne  
18 duhet t'i akomodojmë këto procese, por edhe procesin tonë  
19 gjyqësor.

20 Prandaj ne planifikojmë të vijojmë në këtë formë.

21 Planifikojmë të bëjmë tri javë radhazi, 20 orë në javë, të  
22 shpërndara në katër ditë të javës. E premtja zakonisht është  
23 një ditë që është për aktivitete që nuk kanë lidhje me  
24 procesin gjyqësor. Pastaj një javë nuk do të jetë seanca, atë  
25 javë Trupi Gjykes edhe ju do të përgatiteni për seancat e

1 radhës. Pastaj tri javë të tjera, pastaj do të bëjmë dy javë  
2 shkëputje për të njëjtat arsye, pra, në mënyrë që Trupi  
3 Gjykues të përgatitet. Pastaj do të kthehemi prapë tri javë,  
4 një javë shkëputje. Dhe ky format do të vazhdojë në një  
5 kombinim një dhe dy-javë shkëputje pa asnjë ndryshim, kuptohet  
6 nga ato që thashë.

7 Pushimet e përgjithshme dhe pushimet gjyqësore do të  
8 vijojnë siç janë të përcaktuara.

9 Ky plan do ta mundësojë Trupin Gjykues që të punojë sa më  
10 shpejt që të jetë e mundshme në këto kushte. Ky plan  
11 parashikon një maksimum 620 orë aktivitet në sallën e gjyqit  
12 në vit. Në këtë moment, ne kemi për synim që deklarata hyrëse  
13 nga ZPS-ja, Mbrojtësja e Viktimave edhe Mbrojtësit të jetë  
14 data 1 mars 2023.

15 Në mënyrë që ta realizojmë këtë datë, Trupi Gjykues do të  
16 ketë një konferencë tjetër mbi përgatitjen e çështjes  
17 gjyqësore më 18 janar 2023 edhe konferenca për përgatitjen nga  
18 ana e Prokurorit të Specializuar në zbatim të rregullit 118 do  
19 të jetë në fillim të shkurtit.

20 Rregulli 117(1) parashikon që Trupi Gjykues të organizojë  
21 konferencën përgatitore për gjykim me palët dhe kur është e  
22 mundshme me Mbrojtësen e Viktimave. Trupi Gjykues vlerëson se  
23 pjesëmarrja e Mbrojtësit të Viktimave është e nevojshme dhe  
24 prandaj e fton që të marrë pjesë në konferencën për  
25 përgatitjen e gjykimit.



1 Tani u kërkoj pikëpamjet palëve sa i takon formatit që  
2 unë përmenda pak më herët si dhe planet për fillimin e  
3 gjykimit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Prokuror,  
5 fjala është për ju.

6 Z. QUICK: [Përkthim] Mirëmëngjes. ZPS-ja është dakord.  
7 Mendojmë që kjo ndihmon procedura të shpejta dhe efikase. Ne  
8 mendojmë që duhet të ketë një farë fleksibiliteti sigurisht sa  
9 u takon ditëve që duhet të punojmë në një javë edhe  
10 shkëputjeve që do të kemi që të mos kemi shkëputje të gjata  
11 dhe të panevojshme sepse do të kemi parasysh kohën që duhet të  
12 udhëtojnë dëshmitarët në mënyrë që të jenë të disponueshëm për  
13 dëshmitë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta  
15 diskutojmë më vonë këtë. Por kalendari do jetë relativisht  
16 strikt. Po ju njoftoj paraprakisht. Kështu që ju duhet të  
17 njoftoni paraprakisht, të bëni njoftime paraprakisht, të  
18 njoftoni dëshmitarët që të jenë këtu në dispozicion.

19 Z. QUICK: [Përkthim] E kuptoj.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Ky është propozimi, ne propozojmë  
22 fundit e marsit sepse protokollit që keni pasur për dëshmitarët  
23 na ka penguar shumë përpjekjet tona hetimore. Prandaj në  
24 rastin tim nuk jemi në gjendje të kontaktojmë dëshmitarët e  
25 ZPS-së. Ne kemi pasur intervista me dëshmitarët ndërkombëtarë,

1 të cilët mund desh t'i shkëpusja në orën e njëmbëdhjetë të vet  
2 për shkak të protokollit.

3 Aktualisht protokolli për dëshmitarët është duke u  
4 apeluar nga ana jonë dhe ne kërkojmë të çlirohemi ose kërkojmë  
5 që të rishikohet protokolli për dëshmitarët më saktë, më  
6 specifike sa u takon dëshmitarëve ndërkombëtarë. Dhe në këtë  
7 rast ne kishim një dëshmitar ushtarak në fakt, oficer ushtarak  
8 me vjetërsi, i cili ishte i gatshëm të ulej me mua të  
9 diskutonim masat dhe mu desh ta shtyja. Është ende në pritje  
10 kjo çështje. Kanë kaluar muaj tashmë. Ne kemi dhe disa aspekte  
11 sa i takon nxjerrjes së materialeve nga ana e Prokurorisë sa u  
12 takon orës së njëmbëdhjetë që janë dhe ende 66 dëshmitarë të  
13 redaktuar ose 54, të cilët duhet t'i marrim të dhënat 30 ditë  
14 para gjykimit. Pra na duhet më shumë kohë për të përgatitur  
15 masat hetimore.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë date  
17 propozoni ju?

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Të hënën e fundit të marsit. Po,  
19 pikërisht kjo.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta marrim  
21 parasysh.

22 Z. Emmerson.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po, edhe unë  
24 mbështes të njëjtën gjë.

25 Unë padyshim, i nderuar Gjykatës, duam të dëgjojmë

1   parashtrime me hollësi sa u takon disa dëshmitarëve në fazën  
2   më të hershme të procesit. Po është një çështje, të cilën  
3   duhet ta trajtojmë sa i takon nxjerrjes së materialeve.

4           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, le  
5   ta flasim pak më vonë këtë. Për momentin thjesht duam  
6   pikëpamjen tuaj për fillimin e gjykimit.

7           Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po, pse jemi  
8   ne vonë dua të them unë, mendoj se është e nevojshme të  
9   fillojmë në fund të marsit. Ne propozojmë fundin e marsit për  
10   këtë arsye.

11          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
12          Z. Young.

13          Z. YOUNG: [Përkthim] Ne pajtohemi.

14          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
15   Alagendra.

16          ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes]  
17   Pajtohemi.

18          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses  
19   dëshiron të thotë disa gjëra sa i takon sjelljes së palëve. Në  
20   fakt të gjithë ju këtë e keni parasysh.

21          Fillimisht në përputhje me nenin 10 të Kodit të Sjelljes  
22   Profesionale për avokatët dhe Prokurorinë para Dhomave të  
23   Specializuara, Mbrojtja dhe Prokurorët duhet të respektojnë  
24   Trupin Gjykses. Dhe ne presim që kjo të respektohet gjatë  
25   gjithë procesit gjyqësor.

1 Palët dhe pjesëmarrësit në çdo moment duhet të jenë të  
2 sjellshëm ndaj njëri-tjetrit në sallë dhe jashtë sallës së  
3 gjyqit. Komentet, kritikrat personale ndaj palëve dhe  
4 pjesëmarrësve nuk duhet të tolerohen nga Trupi Gjykses.  
5 Prandaj, palët duhet të fokusohen për ato që janë të  
6 rëndësishme për çështjen dhe urojmë që të mos përdorim  
7 kompetencat tona për të vendosur sanksione.

8 Të gjitha kundërshtimet, komentet, deklaratat në sallën e  
9 gjyqit do t'i drejtohen Panelit edhe jo palës kundërshtare.

10 Palët dhe pjesëmarrësit nuk duhet të përdorin taktika  
11 dredharake dhe sa më shumë të jetë e mundur duhet të  
12 informojnë pjesëmarrësit e tjerë paraprakisht me gojë dhe me  
13 shkrim për kërkesat që duan të bëjnë në sallën e gjyqit. Po  
14 ashtu, Trupi Gjykses pret nga palët dhe pjesëmarrësit të  
15 diskutojnë aspektet që do të dalin rregullisht nga çështja mes  
16 njëri-tjetrit në mënyrë që të gjejnë zgjidhje që nuk kanë  
17 nevojë të shkojnë për debat juridik.

18 Komunikimet me Gjykatësit rregullohen në nenin 11 të  
19 Kodit të Sjelljes. Kontaktet nga palët apo pjesëmarrës të  
20 tjerë me Trupin Gjykses i duhen njoftuar përgjithësisht palës  
21 kundërshtare.

22 Gjithashtu, Trupi Gjykses dëshiron të theksojë faktin që  
23 çdo problem që një palë apo pjesëmarrës ka me palën tjetër apo  
24 me Mbrojtësit që përfaqësojnë palët apo pjesëmarrësit,  
25 fillimisht do ngrihet në përputhje me Kodin e Sjelljes me

1 palën apo avokatin në fjalë. Kur kjo çështje nuk zgjidhet mes  
2 njëri-tjetrit, atëherë do t'i kalojë për zgjidhje sipas Kodit  
3 të Sjelljes Trupit Gjykues.

4 A ndonjë koment lidhur me këtë?

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Asgjë nga ana jonë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
7 ngrini dorën në qoftë se dikush ka diçka për të thënë.  
8 Faleminderit.

9 Përgjegjësia për të garantuar procedura të shpejta dhe të  
10 drejta nuk është vetëm detyrim i Trupit Gjykues, por edhe i  
11 palëve dhe pjesëmarrësve.

12 Trupi Gjykues nuk do të tolerojë asnjë nga taktikat që  
13 vonojnë procesin nga palët. Në çdo moment do të garantojë që  
14 procedurat të jenë në kohë dhe efikase. Trupi Gjykues pret nga  
15 palët dhe nga pjesëmarrës të kontribuojnë në këtë qëllim  
16 brenda fushëveprimit të tyre kuptohet dhe në një mënyrë që  
17 është në përputhje me të drejtat e të akuzuarit dhe të  
18 viktimave pjesëmarrëse.

19 Shtimi i kohës do të jepet vetëm kur të ketë arsye të  
20 forta dhe të qarta. Për më tepër, pala që kërkon një masë të  
21 tillë juridike duhet të bëjë kërkesë për kohë shtesë në kohën  
22 e duhur dhe jo në momentin e fundit.

23 Parashtrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve, qofshin këto  
24 me gojë apo me shkrim duhet të jenë të fokusuara dhe t'i  
25 shërbejnë qëllimit. Palët dhe pjesëmarrësit duhet të shmangin

1 fjalët e gjata, përsëritjet dhe parashtrime për çështje që nuk  
2 kanë lidhje me procesin gjyqësor.

3 A ka ndonjë koment lidhur me këtë? Faleminderit.

4 Tani dua të them diçka në përgjegjësi sa i takon seancave  
5 private dhe të mbyllura si dhe masave mbrojtëse. Trupi Gjykses  
6 udhëhiqet nga fakti që gjykimi duhet të jetë publik, sepse  
7 publiku duhet ta kuptojë dhe të ketë besim te ky proces për të  
8 kuptuar çështjet dhe vendimet që merren në këto gjykime. Dhe  
9 kjo forcohet me tej në ligjet dhe në Rregulloren tonë të  
10 Procedurës dhe Provave që kërkojnë që seancat të jenë publike  
11 sigurisht në vartësi të disa kushteve.

12 Seancat private dhe të mbyllura do të jenë të shkufizuara  
13 dhe më shumë duhet të jenë një përjashtim sesa rregull.  
14 Udhëzohen Mbrojtësit të bëjnë pyetjet me kujdes dhe  
15 kundërpjetjet dhe të mos të shmangin sa më shumë pyetjet që  
16 duhen bërë në seanca private dhe të mbyllura, që do të thotë  
17 të shmangim rastet që të kalojmë në seancë private ose të  
18 mbyllur në mënyrë të përsëritur.

19 Po gjithashtu duhet ta justifikojë shkurtimisht pse do të  
20 kërkojnë seancat private dhe të mbyllura.

21 Tani sa i takon çështjes specifike të redaktimit dhe të  
22 mosxjerrjes të dokumenteve që ka një ndikim të drejtpërdrejtë  
23 në çështjen e këtyre seancave publike.

24 Redaktimi i emrave dhe i informacioneve që mund të  
25 identifikojnë dëshmitarët, viktimat pjesëmarrëse në procesin

1 gjyqësor dhe persona të tjerë që janë në rrezik për shkak të  
2 dëshmimeve që kanë dhënë apo për shkak të pjesëmarrjes në  
3 procesin gjyqësor mund të jetë e nevojshme për të garantuar  
4 mbrojtjen e tyre mbrojtjen e tyre efikase dhe lejohet  
5 sigurisht sipas kornizës tonë ligjore në vartësi të disa  
6 kushteve.

7 Sigurisht masa të tilla në çdo moment do të jenë në  
8 përputhje me mbrojtjen efikase të së drejtave të të akuzuarve,  
9 në veçanti të drejtës për të formuar sa më shpejt dhe me  
10 hollësi mbi natyrën dhe shkakun e akuzave të ngritura kundër  
11 tyre dhe për të pasur kohë të përshtatshme për përgatitjen e  
12 mbrojtjes së tyre.

13 Nevoja për të garantuar sigurisht parimin e seancave  
14 publike do të ndihmojë dhe për të vendosur pastaj se cilat  
15 redaktime janë të domosdoshme dhe proporcionale në kushtet  
16 tona. Domosdoshmëria dhe proporcionaliteti i redaktimeve të  
17 propozuara duhet të demonstronhet siç duhet nga palët  
18 përkatëse.

19 Trupi Gjyqësor vëren se një numër i madh redaktimesh apo  
20 një numër i madh dokumentesh që nuk lejohet të nxirren janë  
21 autorizuar në fazën paraprake sepse ishin të domosdoshme dhe  
22 proporcionale në atë fazë të procesit.

23 Tani që jemi gati të fillojmë gjykimin, Trupi Gjyqësor  
24 mendon që shumë prej këtyre redaktimeve nuk janë më të  
25 nevojshme apo proporcionale. Nëse i mbajmë, shumë prej këtyre

1 redaktimeve në fakt cenojnë në mënyrë krejt të panevojshme të  
2 drejtat themelore të të akuzuarve.

3 Prandaj, Trupi Gjykses do të ndër marrë hap pas hapi masa  
4 për të garantuar që informacioni që të akuzuarit nuk e dinë do  
5 t'u vendoset atyre në dispozicion në mënyrë që të përgatiten  
6 në mënyrë efikase dhe të paraqesin provat e tyre gjatë  
7 gjykimit.

8 Janë tre kategori redaktimesh që aktualisht kanë ndikim  
9 te Mbrojtja, prekin Mbrojtjen: Së pari, redaktimet në  
10 aktakuzë; së dyti, redaktimet në deklaratat edhe provat  
11 materiale të dëshmitarëve që u përkasin katër dëshmitarëve të  
12 parë që synon të thërrasë ZPS-ja në gjykim; së treti,  
13 personat, dëshmitarët dhe provat materiale në listën e ZPS-së  
14 të dëshmitarëve dhe provave materiale.

15 Do ta marr rast rast pas rasti tani.

16 Sa u takon redaktimeve në aktakuzë, kemi parë që ka 70  
17 redaktime që janë ende të zbatuara, 58 prej tyre parashikohen  
18 të hiqen 30 ditë para fillimit të gjykimit, që nëse ecim me  
19 planin që kemi aktualisht, do të jetë 1 shkurti. Pra, ose më  
20 saktë mund të jetë 30 janari në fakt. 12 redaktimet e tjera  
21 parashikohet të hiqen 30 ditë para fillimit të dëshmisë së  
22 dëshmitarit që i përket informacioni konkret.

23 Me përjashtim të një dëshmitari që ka implikime në një  
24 redaktim në aktakuzë, nuk ka asnjë informacion tjetër se kur  
25 do të thërriten dëshmitarët e tjerë nga ana e ZPS-së.



1 Tani në përputhje me nenin 21(4) (a) të Ligjit dhe  
2 rregullin 86, 88(2) dhe 124(2) të Rregullores sonë, Trupi  
3 Gjykues dëshiron të bëjë me dije se planifikon të urdhërojë  
4 heqjen e të gjithave redaktimeve në aktakuzë sa i takon  
5 Mbrojtjes në fakt, jo më vonë se 30 janari 2023.

6 ZPS-ja duhet të demonstrojë, të vërtetojë në fakt nevojën  
7 për t'i mbajtur ende redaktimet në versionin publik të  
8 aktakuzës në përputhje me rregullin 88(2) të Rregullores.

9 Heqja e të gjitha redaktimeve në aktakuzë sa u takon të  
10 akuzuarve duhet të mundësojë që të njoftohen në kohë dhe me  
11 hollësi mbi natyrën dhe shkakun e akuzave të ngritura ndaj  
12 tyre dhe të kenë kohën e mjaftueshme për tu përgatitur.

13 Së dyti, ne mendojmë që ndonëse shumë prej redaktimeve në  
14 materialet provuese që janë nxjerrë që ZPS-ja synon t'i  
15 përdorë në gjykim mund të kenë qenë të domosdoshme dhe  
16 proporcionale, në fazat e para të procesit shumë prej këtyre  
17 redaktimeve tani janë krejt të panevojshme dhe mund të jenë  
18 një pengesë në fakt për përgatitjen në kohë të Mbrojtjes si  
19 dhe për zhvillimin e shpejtë dhe efikas të këtij gjykimi.

20 Bazuar në këto që thashë, pra është vendimi ynë paraprak  
21 që të gjitha redaktimet në materialet provuese që ZPS-ja synon  
22 t'i përdorë apo t'jua tregojë lidhur me 40 dëshmitarët e  
23 tjerë, përfshirë çdo deklaratë dëshmitari që ZPS-ja synon ta  
24 zbulojë duhet hequr parimisht 30 ditë para fillimit të  
25 gjykimit.

1 Këtu përfshihet nxjerrja e identitetit që besoj janë  
2 shtatë nga 40 dëshmitarët e parë synon të thërrasë ZPS-ja,  
3 lidhur me të cilët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka  
4 urdhëruar nxjerrjen me vonesë të materialeve deri 30 ditë para  
5 dhënies së dëshmisë.

6 Sipas regjimit që kemi aktualisht gjatë fazës së  
7 procedurës paraprake, identiteti i këtyre shtatë dëshmitarëve  
8 dhe materiali provues është parashikuar të nxirret 30 ditë  
9 para dhënies së dëshmisë së tyre. Trupi Gjykues synon që të  
10 bëhet në fakt 30 ditë para fillimit të gjykimit; me fjalë të  
11 tjera të nxirret më 30 janar 2023.

12 Tani, Trupi Gjykues mendon se ZPS-ja mund të përgjigjet  
13 në dy forma. Një, ose t'i thërrasë këta dëshmitarë në fillim  
14 të çështjes në mënyrë që masat mbrojtëse që janë në fuqi të  
15 mbeten të tilla, 30 ditë para fillimit të dëshmisë; ose ZPS-ja  
16 mund të kërkojë më masa pak cenuese në mënyrë që të trajtojë  
17 aspektet e sigurisë lidhur me këta dëshmitarë.

18 Për shembull, Trupi Gjykues mund të shqyrtojë lidhur me  
19 këta dëshmitarë çdo kërkesë nga Prokuroria për të kufizuar  
20 përdorimin, informacionin për Mbrojtjen dhe Mbrojtësen e  
21 Viktimave lidhet me këta shtatë dëshmitarë, po sigurisht në  
22 vartësi të disa kushteve. Sigurisht Trupi Gjykues mund të  
23 shqyrtojë kërkesat e ZPS-së për të ndryshuar listën e 40  
24 dëshmitarëve të parë që synon të thërrasë në gjykim, në mënyrë  
25 që të garantojë që të gjitha redaktimet në aktakuzë të mund të

1 hiqen deri më 30 janar 2023.

2 Nëse ZPS-ja nuk ka mundësi që të organizojë në mënyrë të  
3 duhur që këta dëshmitarë të caktuar të dëshmojnë në muajin e  
4 parë të gjykimit, dëshirojmë të na thonë pse nuk mund ta bëjnë  
5 këtë. Por ia lëmë fjalën ZPS-së të na tregojë se çfarë  
6 dëshiron të parashtrojë lidhur me këtë.

7 Sidoqoftë, duam ta bëjmë të qartë se në përputhje me  
8 urdhrat e Gjykatës të Procedurës Paraprake, masat mbrojtëse do  
9 të mbeten në fuqi sa i takon publikut të gjerë.

10 Sa i takon kategorisë së tretë të redaktimeve - pra,  
11 redaktime në deklaratat e dëshmitarëve të tjerë dhe provat  
12 materiale në listën e dëshmitarëve dhe provat materiale të  
13 ZPS-së - synojmë të përdorim të njëjtën mënyrë në fakt dhe të  
14 heqim redaktimet, të urdhërojmë heqjen e redaktimeve për çdo  
15 grup të ri dëshmitarëve të ZPS-së që do të thërritet radhë  
16 pastaj radhe domethënë.

17 Tani do u japim të gjithëve mundësinë të na jepni  
18 pikëpamjet tuaja lidhur me këto aspekte dhe të bëni  
19 parashtrime shtesë para se të japim ne vendimin tonë lidhur me  
20 këtë çështje në janar.

21 Kini parasysh që ne nuk do ta lejojmë sistemin e  
22 redaktimit siç është aktualisht, sepse jemi duke iu afruar  
23 fillimit të gjykimit.

24 Nga ana e ZPS-së.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Tani sa u takon tre urdhrave të

1 parë për aktakuzë ne kuptojmë dhe do të respektojmë afatin që  
2 ju na dhatë.

3 Sa i takon të dytit, i kuptojmë kushtet tuaja, do të  
4 vlerësojmë se cilat kërkesa vërtet janë të nevojshme.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling,  
6 nuk ishte urdhër. Ishte thjesht një deklaratë çfarë synojmë të  
7 bëjmë.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Okej. Sa i takon synimit tuaj  
9 atëherë, ne do të respektojmë këshillën tuaj dhe do të  
10 vlerësojmë se cilat kërkesa janë vërtetë të nevojshme sa i  
11 takon afatit 30 ditë para dhënies së dëshmisë së dëshmitarit.

12 Edhe për urdhrin e tretë, e kuptuam, do e trajtojmë pak  
13 më vonë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. Kehoe.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Shkurtimisht. I vlerësojmë  
17 redaktimet në aktakuzë. Do na ndihmojë jashtëzakonisht për të  
18 ecur më tej me çështjen tonë.

19 Sa i takon redaktimeve të dëshmitarëve që ju përmendët i  
20 nderuar Gjykatës, këtu përfshihen dhe 46.000 faqe që ne  
21 presim.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e dimë,  
23 nuk i numërojmë faqet.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] As unë s'e di numrin e faqeve, po  
25 ZPS-ja më ka thënë që janë rreth 46.000 faqe në fakt, që janë

1 dhurata pastaj Krishtlindjeve në këtë fazë. Do kemi 46.000  
2 faqe dokumente krahas gjithë punëve të tjera që duhet t'i  
3 trajtojmë dhe të hetojmë 30 ditë para fillimit të gjykimit.

4 Me gjithë respekt, i nderuar Gjykatës, kjo është  
5 trajtuar, është ngritur dhe me Gjykatësin e Procedurës  
6 Paraprake. Po jemi në fazën që po heqim redaktime, të nxjerrim  
7 materialet. Nëse mund të afrojmë pak më shumë këtë datën, ta  
8 kemi pak më herët, do të ishte shumë e dobishme për ne se janë  
9 46.000 faqe që janë të vështira për t'u lexuar në 30 ditë, jo  
10 më pastaj t'i përpunojmë dhe të gjejmë ku është pjesa që na  
11 duhet ne apo cilat burime na nevojiten.

12 E them këtë, i nderuar Gjykatës - unë s'e di çfarë ka në  
13 këto dokumente. Po besoj se këto 46.000 faqe të dokumenteve do  
14 të jenë të rëndësishme edhe duhet t'i kishim marrë më përpara.  
15 Kemi dhe aspekte të tjera, por është shumë informacion në fakt  
16 krahas dhe punës tjetër që kemi për të bërë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra për 40  
18 dëshmitarët doni një datë më të hershme po thoni?

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Për 40 dëshmitarët -

20 Pra, ka dy gjëra. Pikësëpari, dokumentacioni, pra 46.000  
21 faqet që do të marrim.

22 Sa u takon dëshmitarëve, po, do të vlerësonim në qoftë se  
23 do të ishte më herët. Po të paktën kemi rendin e dëshmitarëve.  
24 Kush janë 20 të parët për shembull?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta

1 trajtojmë këtë pak më vonë. E kuptoj, ju doni që dokumentet  
2 t'i merrni pak më shpejt apo jo?

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. Kështu ju e thatë në mënyrë  
4 shumë më të qartë dhe të shkurtër sesa unë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Do ta gjykoni se në këtë  
6 mënyrë do të sillemi gjatë gjithë kohës.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, ju falënderoj dhe ju besoj.  
8 Ka dhe një çështje tjetër që ka të bëjë me këta 40 dëshmitarë,  
9 të cilët besoj, i nderuar Gjykatës, do të duhet ta bëjmë në  
10 seancë private. Nuk e di nëse do ta marrim tani apo më vonë  
11 pasi ka të bëjë me dokumentet që kanë të bëjnë me këta  
12 dëshmitarë dhe janë të ndërlidhur njëri me tjetrin.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Emmerson.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar  
16 Gjykatës, dua t'i kthehem çështjes që ngrita pak më herët dhe  
17 nuk do të flas në hollësi, po ka të bëjë me dëshmitarin të  
18 cilit iu referuat ju, i nderuar Gjykatës, kur folët për  
19 kategoritë 1 dhe 2 të dëshmitarëve, që kanë të bëjnë edhe me  
20 redaktimet e aktakuzës edhe të dëshmisë.

21 Kjo çështje është ngritur me shkrim paraprakisht me Zyrën  
22 e Prokurorisë dhe është pjesë e korrespondencës *inter partes*  
23 dhe është e rëndësishme për sa i përket afatit të punës dhe  
24 afateve të punës që keni përmendur i nderuar Gjykatës, pasi  
25 ZPS-ja ka kërkuar që unë të kërkoj të futem në seancë private

1 përpara se t'ju drejtohem juve si Trup Gjykues dhe unë po e  
2 bëj këtë kërkesë në emrin e tyre.

3 Por duke qenë që nuk ka nevojë që të përmend as emrin dhe  
4 as numrin e referencës për sa i përket asaj që do të ngre,  
5 pasi është e qartë, të nderuar Gjykatës, që ju e keni  
6 identifikuar dëshmitarin për të cilin bëhen këto parashtime,  
7 në fakt unë nuk do të isha i këtij mendimi. Por, ndoshta do të  
8 ishte më mirë që të dëgjojmë se cili është mendimi i palës së  
9 Prokurorisë. Pra, nëse duhet që ta dëgjojmë këtë çështje në  
10 seancë private.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Ju faleminderit.

13 Dhe e vlerësojmë që na kanë lajmëruar paraprakisht.

14 Diskutimi që do të bëjë z. Emerson ka të bëjë me njërin  
15 nga dëshmitarët më të mbrojtur të të gjithë çështjes. Është e  
16 natyrës shumë të ndjeshme. Nuk e dimë se çfarë do të përmbajë  
17 ky parashtim dhe prandaj kemi kërkuar që të mbahet në seancë  
18 private.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
20 z. Emerson. Do ta shqyrtojmë atë së bashku me kërkesën që ka  
21 bërë z. Kehoe për seancë private dhe do ta japim pak më vonë.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Dakord.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Young.

24 Z. YOUNG: [Përkthim] Unë do t'i bie shumë shkurt, i  
25 nderuar Gjykatës. Ne i vlerësojmë komentet tuaja lidhur me

1 redaktimet pasi pala mbrojtëse do të dijë se cilat janë  
2 argumentet me të cilat do të përballen.

3 Dhe duke patur parasysh volumin e materialit që do të  
4 nxirret si rezultat i heqjes së këtyre materialeve, sa më  
5 shpejt që të na jepni këto materiale aq më mirë do të jetë,  
6 pasi heqja e redaktimeve do të bëjë të mundur që të kemi  
7 hetime të mëtejshme si pjesë e punës sonë përgatitore me  
8 qëllim që të jemi të drejtë në tërë këtë proces.

9 Z.YOUNG: [Përkthim] Z. Roberts, do t'ju drejtojë me një  
10 çështje tjetër.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
12 Z. Roberts.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes.  
14 A kuptoj si duhet që do të hiqen edhe redaktimet e dosjes  
15 paraprake në të njëjtën kohë, pasi ka të bëjë me redaktimet,  
16 të cilat përsëriten në dosjen paraprake dhe të cilat na kanë  
17 penguar në përgatitjen tonë dhe ne do të kërkonim që të  
18 hiqeshin në të njëjtën kohë si dhe redaktimet e aktakuzës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do ta  
20 marr parasysh.

21 Znj. Alagendra, apo kush do të flasë.

22 Z. BAIESU: [Përkthim] Z. Ellis do të flasë mbi këtë  
23 çështje.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
25 Edhe unë e kam parasysh faktin që nuk duhet të bëjmë



1   parashtrime të përsëritura. E mbështesim atë që kanë thënë  
2   ekipet e tjera të Mbrojtjes.

3           Unë do të mbështes në mënyrë të veçantë parashtrimin e z.  
4   Kehoe, që ne duam që materialet të na jepen më herët sesa 30  
5   ditë përpara fillimit të gjykimit. Pra, kur bëhet fjalë për  
6   këta 40 dëshmitarët e parë.

7           Për sa i përket dëshmitarëve, identiteti i të cilëve do  
8   të nxirret 30 ditë përpara gjykimit, kemi dëgjuar nga ZPS-ja  
9   se bëhet fjalë për 46.000 faqe. Këto do të jetë hera e parë që  
10   do t'i marrim këto materiale pa redaktime. Edhe e kam thënë  
11   edhe herë tjetër se kjo do të bënte që ne të duhej të lexonim  
12   më shumë sesa 1000 faqe në ditë për 30 ditët përpara gjyqit,  
13   që do të thotë që nuk duhet të bëjmë asnjë gjë tjetër si punë  
14   përgatitore. Dhe prandaj ky është një material që nuk duhet  
15   lexuar por duhet analizuar.

16           Kështu që do të donim që ky afat të afrohej që materiali  
17   të na jepet në kohë të mjaftueshme për të na mundësuar  
18   përgatitjen për gjykim.

19           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i  
20   kthehem edhe njëherë kësaj çështjeje z. Halling.

21           Ju i keni dëgjuar të gjitha kërkesat e palës mbrojtëse. A  
22   keni komente për të bërë? A është kjo e mundur për t'u  
23   realizuar nga ana juaj?

24           Z. HALLING: [Përkthim] Po, janë bërë një numër kërkesash,  
25   i nderuar Gjykatës, po do flas sesa të realizueshme janë.

1 Për sa i përket nxjerrjes së materialeve më herët, afati  
2 që keni nxjerrë ju është 30 ditë përpara gjyqit për të mbajtur  
3 ato masa mbrojtëse, të cilat i ka bërë Gjykatësi i Procedurës  
4 Paraprake. Këto masa mbrojtëse kanë qenë të domosdoshme dhe  
5 proporcionale dhe nuk është dhënë ndonjë shpjegim se përse  
6 duhet të kemi këtë afat kohor.

7 Për sa i përket 46.000 faqeve, janë dy komente që do të  
8 bëj se mund të na ndihmojnë për të kuptuar më mirë situatën  
9 lidhur me këtë.

10 E para, jo të gjitha këto faqe janë të njëjta. Dhe ka  
11 shumë mundësi në shumë raste këto janë më pak të redaktuara  
12 dhe janë materiale më pak të redaktuara që janë më parë [e  
13 pakuptueshme]. Dhe të gjitha këto janë 46.000, janë në të  
14 gjitha gjuhët ku janë bërë redaktimet jostandarde - janë në  
15 anglisht dhe në shqip. Kështu që numri faqeve në anglisht do  
16 të jetë rreth gjysmës së kësaj shifre. Desha thjesht ta  
17 paraqisja këtë edhe si volum por edhe si çështje kohore.

18 Edhe një çështje e fundit. Për sa i përket dosjes  
19 paraprake kjo është e ndryshme nga aktakuza sipas nesh. Ne për  
20 sa i përket aktakuzës mendojmë që redaktimet mund t'i  
21 rishqyrtojmë dhe ta realizojmë që kjo të bëhet 30 ditë përpara  
22 fillimit të gjykimit. Por dosja paraprake ka hollësi të  
23 dëshmimeve të dëshmitarëve dhe nuk mund të bëhet heqja e  
24 redaktimeve në të njëjtin afat kohor.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe një gjë

1 tjetër, kemi dëgjuar nga gjithë pala mbrojtëse që kërkon që  
2 gjyqi të fillojë në fund të marsit.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Sipas nesh, gjyqi mund të vazhdojë  
4 në përputhje me afatet që keni përcaktuar ju. Ju takon juve  
5 sidoqoftë. Ne nuk shohim ndonjë arsye se përse gjyqi të mos  
6 fillojë më datën 1 mars siç e keni thënë ju.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
8 ekzistojë opsioni që të bëjmë fjalën hyrëse më datën 1 mars  
9 dhe ta fillojmë gjykimin më vonë. A keni komente për të bërë  
10 këtë?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Komenti im për këtë, i nderuar  
12 Gjykatës --

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni.  
14 [Trupi Gjykses këshillohet]

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Diskutimi që kemi bërë për 46.000  
16 faqet dhe e kemi bërë këtë për muaj të tërë me Gjykatësin e  
17 Procedurës Paraprake dhe e vetëm sot kemi dëgjuar se për se  
18 bëhet fjalë, për çfarë janë këto materiale.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky është  
20 progres.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Megjithëkëtë, kjo përsëri na le në  
22 errësirë. Do të marrim informacione të shumta sidoqoftë dhe  
23 informacione të paredaktuara mbi dëshmitarët, të cilët s'i  
24 kemi patur. Është një informacion i cili duhet analizuar. Dhe  
25 për sa i përket Trupit Gjykses, ne duhet t'i trajtojmë dhe

1 analizojmë këto për të bërë edhe fjalën hyrëse.

2 Dhe ne duam që në këtë deklaratën tonë hyrëse të jemi sa  
3 më të qartë dhe sa më të plotë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
5 Z. Emerson.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mbi këtë  
7 çështje, i nderuar Gjykatës, me duhet t'i kthehem çështjes që  
8 ju e keni përmendur më herët dhe që do ta diskutojmë pak më  
9 vonë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do ta  
11 trajtojmë pak më vonë. Faleminderit për këshillat.

12 Z. Roberts. Z. Young.

13 Z. YOUNG: [Përkthim] Ne e mbështesim parashtrimin e z.  
14 Kehoe për sa i përket datës së mëvonshme. Nxjerrja mund të  
15 ndikojë në bërjen e deklaratave hyrëse dhe ju falënderojmë për  
16 këtë çështje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj  
18 ndjesë z. Young që ju drejtova si z. Roberts.

19 Znj. Alagendra, z. Ellis.

20 Z. BAIESU: [Përkthim] Ne i mbështesim parashtrimet e bëra  
21 nga z. Kehoe dhe z. Young lidhur me nxjerrjen sa më të hershme  
22 të këtij materiali.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Gjykatësi Mettraux ka një pyetje.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Smith.

1 E kam pyetjen për juve z. Kehoe.

2 E kuptoj që për sa i përket datës së hapjes së gjykimit  
3 keni ngritur shqetësimet apo justifikimet për të mos e filluar  
4 më datën 1 mars dhe si justifikim keni thënë protokollin e  
5 dëshmitarëve që është përpara Gjykatës së Apelit, Panelit të  
6 Gjykatës së Apelit.

7 Pyetja që kam për juve është: ju e keni listën e 40  
8 dëshmitarëve të parë, të cilët do t'i thërrasë Prokuroria si  
9 pjesë e argumenteve të saj. Këto dëshmitarë a do të dëshironit  
10 t'i merrnit në pyetje përpara fillimit të gjykimit? Pra, a  
11 ndikon protokollin i dëshmitarëve siç ekziston mbi këtë proces?

12 Dhe pyetja e dytë është që çështjet e nxjerrjes së  
13 materialeve që ndikojnë nëpër kreditin tuaj, a ka të bëjnë me  
14 këta 40 dëshmitarët në fjalë?

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Protokollin  
16 ndikon mbi një numër prej këtyre 40 dëshmitarëve. Lidhur me  
17 disa dëshmitarë ndërkombëtarë mund ta shpjegoj pa e thënë  
18 emrin, është një dëshmitar, i cili është në listën e  
19 dëshmitarëve të ZPS-së, por është edhe një nga dëshmitarët të  
20 cilët i kërkuam Gjykatësit të Trupit Gjykses që ta marrë  
21 deklaratën [sipas përkthimit], i kërkuam Gjykatësit të  
22 Procedurës Paraprake që ta dëgjojë këtë.

23 Por, është një nga dëshmitarët me të cilin unë kam folur  
24 si zyrtar i kësaj Gjykate në mënyrë paraprake. Por Gjykatësi  
25 Mettraux, protokollin më ndaloi që ta ndiqja më tej këtë

1 çështje.

2 Pra ne duam, ne mendojmë që kjo do të vijë në fillim të  
3 gjykimit. Është një dëshmitar, të cilin ne duam, me të cilin  
4 duam të shpenzojmë një kohë shumë të gjatë, pasi ka patur një  
5 aktivitet shumë të gjerë në vitin 1998-1999.

6 Për sa i përket redaktimeve. Redaktimet lidhur me këta 40  
7 dëshmitarë mund të them që na kanë treguar se cilët janë  
8 dëshmitarë por, po të shihni këto deklarata, do të shihni që  
9 redaktimet janë të shumta në të gjitha këto dhe nuk kanë një  
10 shpjegim të qartë dhe të plotë me atë që do të thonë këta  
11 dëshmitarë.

12 Redaktimet janë të jashtëzakonshme pasi janë fshirë data,  
13 vendndodhje. Ndërkohë njerëzit e tjerë, të cilët kanë luajtur  
14 rol në atë kontekst të shumë rrallë. Pra të gjithë këto janë  
15 çështje të ndërlidhura me pyetjet që mund t'i bënim këtij  
16 dëshmitari.

17 Gjykatësi i Procedurës Paraprake na ka kërkuar në mënyrë  
18 specifike lidhur me njoftimin për alibinë. Për këtë dhe kam  
19 thënë që duke patur parasysh redaktimet që kemi marrë ka qenë  
20 e pamundur. Dhe ajo që jemi përpjekur të bëjmë në dosjen tonë  
21 paraprake është që të japim një shpjegim pak të shkurtër se ku  
22 ka qenë Presidenti Thaçi gjatë asaj periudhe kohore. Në qoftë  
23 se kjo zgjidh çështjen e alibisë apo jo, unë nuk e di, pasi  
24 duhet të më jepet informacion më specifik, më i posaçëm. Dhe  
25 Gjykatësi Mettraux fatkeqësisht kjo do kohë për të gjetur se

1 ku ka qenë dikush në një kohë të caktuar, në një vend të  
2 caktuar e kështu me radhë. Po kjo nuk është çështja e vetme.

3 Unë e nxjerr këtë si çështje të hapur, pasi është një  
4 çështje e cila ka dalë gjatë gjithë kohës të Procedurës  
5 Paraprake.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. HALLING: Nëse më lejoni të flas diçka lidhur me këtë  
8 parashtrimin e fundit, i nderuar Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj  
10 ndjesë se e kisha mikrofonin të mbyllur. Vazhdoni.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Për sa i përket protokollit,  
12 Mbrojtja e ka ngritur këtë çështje edhe më parë dhe ka thënë  
13 që ai është, përbën pengesë për hetimet e tyre që në fakt  
14 është një keqinterpretim i protokollit. Protokolli vetëm  
15 tregon modalitetin e kontakteve që duhet të bëhen me  
16 dëshmitarët e palës kundërshtare.

17 Mbrojtja e Thaçit, në fakt asnjë nga Mbrojtjet e tjera  
18 nuk janë përpjekur që ta shfrytëzojnë protokollin në mënyrën e  
19 tyre. Ky është një vendim dhe nuk është një kufizim që është  
20 bërë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

21 Por, në përgjithësi për sa i përket sugjerimit të Trupit  
22 Gjykses për ta ndarë periudhën me fazën e deklaratave hyrëse  
23 dhe Gjykatës, ne jemi të gatshëm që të vazhdojmë menjëherë. Ne  
24 në qoftë se ju dëshironi që ta vononi sidoqoftë fillimin e  
25 gjykimit, preferenca jonë do të ishte që t'i vonojmë të dyja,

1 edhe deklaratat hyrëse edhe fillimin e gjyqit. Nëse më lejoni  
2 që t'i përgjigjem menjëherë argumenteve të palës së ZPS-së  
3 lidhur me protokollin.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, dikush  
5 tjetër po e bën këtë çështje. Nuk dua të flas më shumë gjatë.  
6 Duhet t'i biem shkurt.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Protokolli kërkon që ne të mos  
8 marrim intervistën e asnjë dëshmitari, i cili do të filmohet  
9 në Zyrën Administrative, pasi kjo çështje do të bëhej vetëm me  
10 praninë e ZPS-së.

11 Po në fakt kjo është një pengesë. Në qoftë se kjo nuk  
12 është pengesë për palën Mbrojtëse më korrigjoni ju lutem. Por  
13 me gjithë respektin tim për kolegët e mi - dhe kam përvojë  
14 shumë të madhe, siç keni dhe ju të nderuar Gjykatës - dhe kjo  
15 është një pengesë mjaft e ndjeshme.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, a  
17 keni ndonjë koment për të bërë lidhur me redaktimet, me  
18 seancat private e kështu me radhë?

19 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, edhe ne kemi marrë materiale në  
20 formë të paredaktuar dhe nuk kemi asgjë tjetër për të shtuar.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 A përfundam më këtë temë? A ka ndokush tjetër, a  
23 dëshiron ndokush tjetër të flasë? Atëherë kalojmë.

24 Për sa i përket çështjeve që duhet të ngremë dhe sa të  
25 përshtatshme do të jenë ato. Për të bërë një gjykim të drejtë



1 dhe të shpejtë, ky Trup Gjykues nuk do të lejojë pyetje apo  
2 përpjekje për të futur prova materiale, të cilat nuk kanë  
3 lidhje të drejtpërdrejtë me këtë çështje. Trupi Gjykues vëren  
4 se nuk do t'i lejojë palët që të bëjnë rrëfime historike, të  
5 cilat nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me përfundimin e  
6 kësaj çështjeje gjyqësore.

7 Trupi Gjykues vëren po kështu se ndryshe nga ajo që është  
8 thënë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk është në gjyq këtu,  
9 nuk është në gjykim. Në qoftë se kështu e kupton pala  
10 Mbrojtëse argumentin e ZPS-së, kjo nuk është përfundimi i  
11 Trupit Gjykues. Këtu janë katër të akuzuar që gjykohen dhe  
12 askush tjetër.

13 Edhe sugjerimi nga ana se krijimi i një Kosove të pavarur  
14 ishte një rezultat i një plani kriminal, nuk është kuptimi  
15 jonë dhe nuk është kjo çështje e paraqitur në aktakuzë.

16 Tani po i rikthehem parashtrimeve që sugjerojnë që forcat  
17 serbe kanë bërë një numër të madh krimesh serioze kundër  
18 shqiptarëve të Kosovës dhe të tjerëve gjatë periudhës kohore  
19 në fjalë.

20 Pala Mbrojtëse thotë që kjo periudhë, këto krime kanë  
21 ndikuar mbi operacionet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe  
22 mënyrën sesi ajo e ka strukturuar veten e saj.

23 Për sa i përket sugjerimit të krimeve serbe gjatë asaj  
24 kohe, a mund ta kuptojmë këtë se kjo nuk është e diskutueshme  
25 nga ana e ZPS-së? Dhe po të jetë e vërtetë një gjë e tillë

1 atëherë nuk ka nevojë që të ketë parashtrime apo diskutime mbi  
2 këtë çështje, z. Prokuror.

3 Z. Prokuror, a është kjo çështje e diskutueshme, e  
4 kundërshtueshme?

5 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Jemi dakord me qëndrimin  
6 tuaj.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
8 Atëherë me atë që kemi sqaruar tani, pra krimet serbe nuk janë  
9 çështje të cilat janë të diskutueshme, kështu që nuk ka nevojë  
10 që të dëgjojmë përmbi këto çështje. Për më tepër, në qoftë se  
11 Mbrojtja do të demonstrojë që një incident lidhur me krimet  
12 serbe ka ndikuar mbi operacionet për funksionimin e Ushtrisë  
13 Çlirimtare të Kosovës në një mënyrë që ka lidhje me argumentet  
14 që do të paraqesë Prokuroria, ne sigurisht do ta lejojmë që të  
15 paraqesin provat e tyre lidhur me këtë fakt. Në të njëjtën  
16 kohë, ne nuk do të lejojmë paraqitjen e provave me krimet  
17 serbe, thjesht për të treguar se ky ishte konteksti i  
18 ngjarjeve të 1998-1999 në Kosovë.

19 Ky Trup Gjykses do të merret vetëm me çështjet dhe  
20 rrethanat që ka të bëjnë vetëm me të akuzuarit që janë këtu.  
21 Ne nuk jemi këtu një shoqatë historike dhe nuk do t'i lejojmë  
22 palët që ta shndërrojnë këtë gjyq në një leksion historie, a e  
23 kuptoni?

24 Z. Kehoe, e shoh që po ngriheni në këmbë.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Në momentin e duhur, të nderuar

1 Gjykatës, ne do të diskutojmë sesa, se ç'lidhje kanë krimet  
2 serbe me provat që do të paraqesim.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është  
4 kërkesa jonë e vetme.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, jemi dakord.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndokush  
7 tjetër?

8 Vazhdoni, z. Emmerson. Nuk kisha ndërmend t'ju  
9 anashkaloja.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ne kemi  
11 paraqitur qartë në dosjen tonë paraprake sesi këto çështje  
12 mund të ndikojnë mbi disa nga çështjet apo konkluzionet që  
13 ZPS-ja kërkon konkluzion apo përfundimin nga Trupi Gjykses.  
14 Dhe është një numër incidentesh, shpejtësia e të cilëve  
15 përsëritet në aktakuzë dhe mund të thojë duhet parë konteksti  
16 me qëllim që të diskutojmë edhe në fakt në mënyrë të arsyeshme  
17 atë konkluzionin që kërkon të nxjerrë ZPS-ja. Nga pala  
18 Mbrojtëse, ne jemi përpjekur që të kufizohemi në konkluzionet  
19 që ka nxjerrë Trupi Gjykses apo apelet e Tribunalit të Hagës  
20 lidhur me këtë çështje dhe të cilat mund të diskutohen fare  
21 shkurtimisht nëse dëshironi.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
23 z. Emmerson.

24 Ne e kemi bërë të qartë që lidhja e drejtpërdrejtë e  
25 ngjarjeve do të jetë ajo që ne do të lejojmë, ne do të

1 shikojmë me vëmendje shumë të madhe se cilat prova do të  
2 paraqiten para nesh dhe do të lejojmë vetëm atë që ka të bëjë  
3 me pretendimet që ngrihen kundër këtyre katër të akuzuarve dhe  
4 vetëm kundër tyre.

5 Z. ELLIS: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nëse më lejoni  
6 të them diçka mbi këtë çështje, i nderuar Gjykatës.

7 Unë jam z. Ellis në emër të Mbrojtjes Krasniqi. Edhe ne e  
8 kemi paraqitur qartë qëndrimin tonë në paragrafin 54 të dosjes  
9 sonë paraprake. Ne e vlerësojmë paraqitjen e dëshmive të  
10 lidhura me këtë çështjen në këtë çështje dhe do të mbajmë  
11 parasysh udhëzimet që keni nxjerrë ju i nderuar Gjykatës.  
12 Megjithatë, provat lidhur me krimet serbe në vende të ndryshme  
13 në pika kohore të ndryshme mund të kenë lidhje të  
14 drejtpërdrejtë me synimin e pretenduar të përbashkët që  
15 paraqitet në këto argumente për kryerjen e këtyre krimeve në  
16 këto vende përkatëse.

17 Pra, unë e kuptoj që ne duhet të demonstrojmë se për se  
18 ka lidhje një dëshmi e caktuar me një ngjarje të caktuar dhe  
19 jemi përpjekur ta bëjmë këtë dhe në dosjen tonë paraprake. Siç  
20 e thashë ne jemi përpjekur që t'i paraqesim ZPS-së pikat tona  
21 të përbashkëta të dakordësuar lidhur me krimet serbe, të cilat  
22 i kanë refuzuar. Dhe unë do të thoja që çështjet janë  
23 specifike dhe duhen pranuar të tilla. Nuk mund të pranohet  
24 thjesht një deklaratë e ZPS-së që të thotë që ne e pranojmë që  
25 ka patur krime serbe. Por ne duam që të jemi më specifikë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe ne i  
2 inkurajojmë diskutimet me palën kundërshtare.

3 Tani kemi disa pyetje për disa nga ju. Secili nga ne do  
4 të bëjë pyetjet e veta. Dhe tani unë do të bëj pyetjen e parë  
5 dhe po e bëj për ZPS-në.

6 Si dëshiron t'i paraqesë argumentet e saj në përgjithësi  
7 ZPS-ja? Me fjalë të tjera, dëshmitarët që do të thirren do të  
8 vijnë me kategori, me bazën e krimit, me komandën apo  
9 strukturën komanduese apo do ta bëni në mënyrë tjetër, në  
10 mënyrë kronologjike apo çfarë?

11 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
12 Gjykatës. ZPS-ja do të përpiqet ta bëjë këtë me qëllim që të  
13 kuptojmë procesin dhe dëshmitë që do të paraqiten. Dhe që të  
14 jetë një gjyq i drejtë dhe i efektshëm dhe kjo kërkon që të  
15 balancojmë një numër faktorësh që ka të bëjnë me  
16 disponueshmërinë dhe sigurinë e dëshmitarëve dhe përgatitjen e  
17 tyre dhe nuk ka një rregull apo rend logjik për paraqitjen e  
18 dëshmisë tonë. Dëshmitë janë të ndërlydhura dhe jo vetëm  
19 kronologjikisht e gjeografikisht por edhe tematikë nga  
20 pikëpamja tematike, për shembull kur flitet për komandën dhe  
21 kontrollin, kategoritë e kundërshtarëve dhe rolet individuale  
22 që kanë luajtur të akuzuarit dhe anëtarët e tjerë të  
23 Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët (JCE).

24 Ka një emër dëshmitarësh që do të vijnë për t'u paraqitur  
25 për një numër vendesh të krimit dhe për këto arsye ne nuk mund

1 t'ju tregojmë që dëshmitë tona do t'i bëjmë pikërisht sipas  
2 atyre që keni paraqitur juve. Por ne do të shohim të gjithë  
3 dëshminë tonë në mënyrë të ekuilibruar.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A më thoni që  
5 ju nuk keni plan si do të procedoni kush është dëshmitar i  
6 parë, kush është i dyti? A ka të bëjë me strukturën  
7 komanduese? A ka të bëjë me një krim të caktuar? Unë besoj që  
8 në këtë pikë ju do të keni ide më të qartë.

9 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
10 sigurisht që kemi plane dhe ide dhe jemi të gatshëm që t'ju  
11 paraqesim juve. Ajo që desha të thoja është që dëshmia nuk do  
12 të jetë e rregulluar në mënyrë kronologjike, gjeografike, apo  
13 tematike. Të gjithë këta faktorë ne do t'i marrim parasysh kur  
14 të paraqesim rendin e dëshmitarëve.

15 Për shembull, një shembull kemi disa dëshmitarë  
16 ndërkombëtarë, të cilët kanë të bëjnë me disa viktima të  
17 ndryshme, krime të ndryshme, periudha të ndryshme dhe role të  
18 ndryshme të luajtura nga të akuzuarit. Dhe ne do të mendojmë  
19 që dëshmitë do të kuptohen lidhur me tematikën e tyre dhe do  
20 të shohim se cilët dëshmitarë do të duhet të thirren që të  
21 jetë logjike gjithë kjo çështje dhe kur do të thirren me  
22 qëllim që ta kuptojmë sa më mirë dëshminë që duam ta  
23 paraqesim.

24 Ne jemi të gatshëm t'ju japim hollësi të mëtejshme me  
25 mënyrën e procedimit. Do ta bëjmë këtë ndoshta më mirë me

1 shkrim pasi do të jemi në gjendje që të flasim në mënyrën më  
2 të posaçme për secilin dëshmitar apo bllok dëshmitarësh.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të na  
4 e dërgoni këtë përpara konferencën sonë të parë të përgatitjes  
5 për përgatitjen e çështjes?

6 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Përvoja jonë tregon që kjo  
7 bëhet me pjesë dhe kemi nevojë që të gjitha këto t'i bëjmë  
8 pasi ta kemi vlerësuar afatin kohor në mënyrën më të mirë dhe  
9 ne mund ta bëjmë këtë për ju të nderuar si Trup Gjykes duke  
10 paraqitur dëshmitarët me grupe.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, grupe  
12 dëshmitarësh - ju thatë 40 dëshmitarë - dhe pastaj ju do të  
13 flisni për një -- dhe më pastaj do të bëhet fjalë për grupe më  
14 të vogla dëshmitarësh që do të paraqiten javë për javë. Dhe  
15 prandaj po ju pyes nëse ky material që do të paraqisni ju me  
16 shkrim, a do të jetë përpara konferencës së parë përgatitore?

17 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne do  
18 t'ju japim juve me shkrim atë që juve do të kërkonit të merrni  
19 me shkrim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.  
21 Atëherë pikërisht këtë do të bëjmë. Faleminderit.

22 Gjykatësi Gaynor, ju kishit një pyetje.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
24 Smith.

25 Pyetje për ZPS-në. Kur dëshiron ZPS-ja të kërkojë

1 pranimin e dëshmimeve të shkruara sipas rregullave 153, 154, dhe  
2 155? Dhe në mënyrë të veçantë, kërkesat e rregullit 155 për sa  
3 i përket dëshmitarëve që kanë ndërruar jetë si do të  
4 procedohet?

5 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar. Unë do  
6 t'i përgjigjem kësaj pyetjeje.

7 ZPS-ja e ka treguar në mënyrë të qartë që këto kërkesat  
8 tona për dëshmitarët e rregullit 153 dhe 154 do t'i paraqesim  
9 përpara fillimit të gjyqit.

10 Edhe për sa i përket pyetjes suaj specifike për  
11 dëshmitarët që kanë ndërruar jetë, ne do të mund ta bëjmë këtë  
12 si pjesë e një dokumenti përmbledhës. Megjithatë, ekzistojnë  
13 një numër faktorësh të tjerë që e komplikojnë këtë çështje,  
14 pasi po marrim dokumente në vazhdimësi përfshirë edhe  
15 certifikatat e vdekjes. Dhe po bëhen të gjitha përpjekjet e  
16 mundura për ta përshpejtuar këtë procedurë.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
19 Smith.

20 Nja dy pyetje nga ZPS-ja që kanë të bëjnë me 154 dhe 155  
21 [sipas përkthimit] edhe kërkesën në veçanti që është në  
22 rregullin 153(2), ku kërkohet prania e firmës e një numri të  
23 individëve - të intervistuesit, të intervistuarit, apo të  
24 Mbrojtësit të dëshmitarit.

25 Ne kemi filluar të lexojmë materialet që ju propozoni të



1 paraqisni në bazë të këtyre rregullave dhe në shumicën e  
2 këtyre rasteve ato janë intervista, të cilat nuk janë marrë si  
3 deklarata tradicionale por janë si intervista fjalë për fjalë.

4 A mund, a po thoni që këto procesverbale përmbushin  
5 kritere të rregullit 154(2), në qoftë se ju këtë rregull doni  
6 ta shfrytëzoni? Dhe nëse po, mbi ç'bazë?

7 Dhe pyetja e dytë, dhe po jua bëj të dyja që të  
8 përgjigjeni në të njëjtën kohë. A e kuptojmë si duhet që kur  
9 të kërkoni që të pranohen si prova deklaratat në bazë të  
10 këtyre dy rregullave 153-154, a do të paraqiten për  
11 vërtetësinë e përmbajtjes së tyre dhe asnjë arsye tjetër? A e  
12 kuptoj si duhet apo ka ndonjë shpjegim tjetër të cilin do të  
13 duhet të na e jepni?

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përpara se të filloni,  
15 Gjykatësi Gaynor më korrigjoi dhe këtë duhet ta bëj  
16 rregullisht. Nuk është rregulli 154, po 153 dhe çmoj  
17 intervenimin e Gjykatësit Gaynor.

18 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Në lidhje me rregullin 153(2).

19 Sipas kësaj rregulle, deklaratat e dëshmitarëve apo  
20 transkriptet e dëshmive të tyre nga procedurat e mëparshme  
21 mund të paraqiten si prova mbas kësaj rregulle. Dhe kriteri i  
22 nënshkrimit në rregullin 153(2) nuk zbatohet në lidhje me  
23 transkriptet e dëshmive në procedura të mëparshme.

24 Për mendimin tonë, këtu përfshihen edhe transkriptet e  
25 intervistave të incizuara që dorëzohen si prova në bazë të

1 rregullit 153(1). Nuk ka çështje që kanë të bëjnë me  
2 autenticitetin apo besueshmërinë apo vlerën provuese të tyre.  
3 Dhe ka tregues të saktësisë të këtyre transkripteve, që  
4 kërkohen sipas rregullës dhe disa prej tyre janë identifikimi  
5 i të dhënave personale, data, koha e marrjes së intervistës  
6 dhe vendi që kërkohet sipas kësaj rregulle.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, këto deklarata do t'i  
8 dorëzoni për vërtetësinë e përmbajtjes së tyre, po ose jo?

9 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Mund të ketë përjashtime. Për  
10 pjesën më të madhe të tyre mund të them se do të dorëzohen për  
11 vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në lidhje me atë që thatë  
13 për paragrafin 1 të rregullit 153, parashtrimet tuaja a do të  
14 jenë të ngjashme, në qoftë se procesverbali i intervistës nuk  
15 është marrë nga ZPS-ja apo nga ndonjë palë e tretë?

16 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Në situata të tilla kjo do të  
17 varet në qoftë se procesverbali i një interviste është  
18 përgatitur për qëllime të procedurave vendore apo për qëllime  
19 të tjera.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam një  
21 pyetje të dytë që lidhet pikërisht me 40 dëshmitarët e parë.

22 Një numër masash janë në fuqi dhe janë urdhëruar dhe ne  
23 nuk duam të marrim në momentin e fundit kërkesa për ndryshimin  
24 e këtyre masave. E kemi të qartë se në rrethana të veçanta  
25 mund të bëhen kërkesa të tilla varësisht nga rrethana

1 personale të këtij apo atij dëshmitari. Thjesht duam të dimë  
2 në qoftë se ZPS-ja ka marrë masa për të verifikuar me  
3 dëshmitarët tuaj në qoftë se masat mbrojtëse janë në fuqi, pra  
4 masat që janë aktualisht në fuqi duhet të ndryshojnë? Dhe  
5 pyetja ime është në qoftë se 'nuk janë marrë' masa të tilla,  
6 kur ZPS-ja planifikon t'i marrë këto masa?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

8 Ne jemi në kontakt me dëshmitarët në lidhje me masat e  
9 tyre mbrojtëse dhe në qoftë se duhet ndryshimi i këtyre masave  
10 ne këtë e kemi raportuar ka një procedurë njoftimi në lidhje  
11 me ndryshimin e masave mbrojtëse. Në rast të tillë duhet të  
12 njoftohet Mbrojtja. Në qoftë se do të ketë kërkesë të tillë  
13 atëherë duhet të tregohen arsyet e një kërkesë të tillë.

14 Nuk presim të kemi kërkesa të tilla në minutën e fundit,  
15 mirëpo në qoftë se do të ketë, atëherë padyshim që do t'ia  
16 themi këtë Trupit Gjykues në kohë dhe të ndjekim të njëjtën  
17 procedurë sikurse është ndjekur edhe në çështjen Gucati dhe  
18 Haradinaj.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
20 për përgjigjen.

21 Gjykatësi Barthe ka një pyetje. Nuk e kam harruar  
22 Mbrojtjen, ta keni parasysh.

23 Gjykatësi Barthe.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

25 Edhe pyetja ime është për ZPS-në. Trupi Gjykues ka marrë

1 parasysh kuadrin kohor të përafërt që keni dhënë edhe 40  
2 dëshmitarët që do t'i thërrisni për të dhënë dëshmi në  
3 parashtrimet që keni dhënë bërë më 18 tetor 2022 [sipas  
4 përkthimit]. Dhe tani dua t'ju pyes në lidhje me kohën që do  
5 t'ju duhet. Pse për shembull ju duhen gjashtë, nëntë apo  
6 trembëdhjetë orë për një dëshmitar sipas rregullit 154,  
7 veçanërisht duke marrë parasysh faktin që ky rregull shërben  
8 për përshpejtimin e procedurave?

9 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Dua të jem e qartë se ne synojmë  
10 që të përdorim sa më pak koha që është e mundshme. Ky përafrim  
11 i kohës shërben për të dhënë një farë përshtypje [e  
12 pakuptueshme] reale për procesin e dëshmive sipas rregullit  
13 154.

14 Është edhe çështja që dëshmitarët sipas rregullit 154 -  
15 kjo kohë do t'ju mundësojë atyre që të hedhin dritë në lidhje  
16 me disa elementë të nevojshëm të dëshmisë së tyre për sa i  
17 përket ndikimit, për shembull sa i përket ndikimit të atyre  
18 ngjarjeve në jetën e viktimave.

19 Pastaj një arsye tjetër është se për shkak se ka kaluar  
20 një kohë e gjatë, ndoshta do të duhet një kohë më e gjatë për  
21 dëshmitarët që dëshmojnë në gjyq për të përfunduar me dëshmitë  
22 e tyre.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe, a  
25 keni komente në lidhje me këto parashtrime të ZPS-së?

1           Z. KEHOE: [Përkthim] Shpresoj t'i kem mbajtur mend të  
2 gjitha. Së pari, në lidhje me pyetjen tuaj për organizimin e  
3 Prokurorisë në përgatitje të gjykimit, reagimi im ishte i  
4 ngjashëm me të tuajin sepse edhe unë kam menduar se në atë  
5 kohë dhe mendoj se ata nuk e dinë radhitjen e dëshmitarëve apo  
6 si do të vazhdojnë.

7           Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk  
8 është e pranueshme që avokati i Mbrojtjes të më atribuojë  
9 fjalë që unë nuk i kam thënë. Dhe mendoj që avokatët duhet të  
10 përmbahen nga komente të tilla.

11           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
12           Vazhdoni z. Kehoe.

13           Z. KEHOE: [Përkthim] Neve na duhet një udhëzues sesi do  
14 të vazhdojë ky gjykim. Ne mund ta bëjmë në mënyrë të shpejtë  
15 në qoftë se, për shembull, i marrim parasysh këto kërkesa të  
16 rregullit 154 apo 153. Këto mund të përshpejtohen, por ajo që  
17 duhet të bëhet është sesi duhet t'i trajtojmë këto çështje që  
18 bien në rregullin 153 dhe 154.

19           E dyta, në lidhje me pyetjen e Gjykatësit Gaynor për  
20 dëshmitarët e rregullit 153 dhe 154 - më falni - kërkesat e  
21 rregullit 154 dhe 155.

22           Ne nuk do t'i kundërshtojmë të gjitha, mirëpo ka disa  
23 deklarata që do të jenë tejet problematike për arsye të  
24 ndryshme. Pyetja e Gjykatësit Mettraux në lidhje me rregullin  
25 153(1) dhe 153(2). Për fat të keq nga përvoja që kemi nga

1 tribunalët e tjerë ndërkombëtarë është se në ato raste nuk  
2 kemi pasur transkripte nga vende të treta apo subjekte të  
3 treta. Në këtë rast këtu kemi deklarata të marra nga EULEX-i,  
4 UNMIK-u dhe kështu me radhë dhe nga vetë Gjykatat e Kosovës.

5 Kështu që pyetja e Gjykatësit Mettraux mund të thuhet se  
6 çështjet do të zgjidhen rast pas rasti. Për shembull në qoftë  
7 se një dëshmitar sipas rregullit 154(2) nuk e ka lexuar  
8 transkriptin e një deklarate të mëparshme, atij mund t'i jepet  
9 edhe kohë që të vërtetojë atë deklaratë të mëparshme. Ne  
10 parashtrojmë se janë raste të rralla ato kur thjesht mund t'ia  
11 japësh transkriptin dëshmitarit e t'i thuash, "ja, këtë e ke  
12 thënë dhe kjo është ajo realja që e ke thënë dhe duhet ta  
13 nënshkruash". Pra gjithë rastet duhet të zgjidhen një nga një  
14 ashtu siç vijnë.

15 Për sa u përket masave mbrojtëse, më inkurajojnë komentet  
16 që bëjnë kolegët e mi se po e monitorojnë këtë gjendje me  
17 dëshmitarët e tyre në lidhje me ndryshimin e atyre masave  
18 mbrojtëse. Ne e kemi informuar ZPS-në që dëshmitarët e tyre  
19 kanë dhënë deklarata publike në televizion apo në media në  
20 Prishtinë. Disa nga këta njerëz kanë bërë deklarata publike  
21 dhe vazhdojnë të jenë dëshmitarë të mbrojtur të Prokurorisë  
22 edhe në këtë moment gjersa po flasim. Dhe ne e inkurajojmë  
23 ZPS-në që t'i kthehet kësaj çështjeje edhe njëherë dhe t'i  
24 kushtojë kujdes më të madh.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

1 z. Kehoe.

2 A keni diçka për të shtuar, z. Emerson?

3 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I vetmi  
4 koment që kam të bëj prek çështjen për të cilën ju duhet të  
5 merrni vendim në qoftë se doni t'i dëgjoni parashtrimet e mia  
6 seancë të hapur apo në seancë private.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. Young.

9 Z. YOUNG: [Përkthim] Dua thjesht të shtoj diçka që nuk u  
10 tha nga kolegët e mi. Ju sigurisht jeni në dijeni që për një  
11 shënim të datës së 18 nëntorit që ka të bëjë me faktet e  
12 propozuara, 135 faktet e propozuara. Realiteti është ky -  
13 Mbrojtja nuk do të pajtohet me faktet e propozuara për  
14 marrëveshje midis palëve.

15 Këto pika janë mjaft të rëndësishme. Lidhen me disa  
16 periudha kohore të përfshira në aktakuzë, lidhen me disa  
17 karakteristika mjaft të rëndësishme të çështjes gjyqësore. Dhe  
18 Prokuroria nuk do t'i kundërshtojë krimet e kryera nga serbët  
19 -ne e mirëpresim këtë fakt.

20 Por ne duam të dimë saktësisht se cili është pozicioni i  
21 ZPS-së në lidhje me këtë, sepse e kanë ndryshuar këtë qëndrim  
22 nga refuzimi në pranimin e 135 fakteve. Por ne nuk kemi marrë  
23 një deklaratë të qartë për ta ditur se ku qëndrojmë. Në  
24 dokumentin publik që ju e keni mund t'i shikoni këto.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. Young. Z. Ellis. Kërkoj falje.

2 Z. BAIESU: [Përkthim] I pranojmë të gjitha dhe pajtohemi  
3 me të gjitha parashtimet e palëve të tjera, pra të ekipeve të  
4 tjera të Mbrojtjes dhe do të përgjigjemi me shkrim, atëherë  
5 kur ZPS-ja do të dorëzojë kërkesën e vet për pranimin e  
6 deklaratave me shkrim sipas rregullit 153, 154, 155 dhe këtu  
7 përfshin edhe deklaratat dhe transkriptet që janë marrë nga  
8 gjykata të tjera ose subjekte të tjera, siç janë EULEX-i,  
9 UNMIK-u dhe kështu me radhë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja i ka  
11 parë, pra, emrat e 40 dëshmitarëve, apo i ka marrë 40  
12 dëshmitarët e parë dhe e dinë, është e njohur me identitetin e  
13 disa prej tyre. A planifikohet ndonjë marrje në pyetje më e  
14 gjatë e tyre? A keni pasur mundësi ta vlerësoni sa kohë do  
15 t'ju duhet?

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam një përgjigje për këtë, por  
17 dëshmitarët që i kam vlerësuar deri tani mund t'ju them se  
18 pyetjet për ta do të jenë të gjata. Kam kaluar shumë kohë edhe  
19 me kolegët e mi në lidhje me dëshmitarët ndërkombëtarë. Ka  
20 disa redaktime pra, pyetjet e Mbrojtja do të jenë të gjata.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë e quani  
22 ju "të gjatë"? Për shembull kohë të gjatë për marrje në  
23 pyetje, një ditë?

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, një ditë. Nuk do të bëj  
25 kundërpjetje për gjëra që lidhen me klientin tim. Unë do të



1 përqendrohem në çështjet që lidhen me klientin tim dhe me  
2 Ndërmarrjen Kriminale të Përbashkët (JCE).

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po meqë  
4 ekipet e Mbrojtjes i diskutojnë çështjet e marrjes në pyetje  
5 të dëshmitarëve të palës tjetër, a ekziston mundësia e  
6 konsolidimit të marrjes në pyetje të këtyre dëshmitarëve?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju e keni të qartë të nderuar  
8 Gjykatës se marrjet në pyetje të dëshmitarëve të Prokurorisë,  
9 domethënë për secilin ekip të Mbrojtjes janë të veçanta dhe të  
10 orientuara drejt klientit që përfaqësojnë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë e kam të  
12 qartë. Por nuk dua për shembull që secili ekip i Mbrojtjes për  
13 të njëjtën gjë të bëjë pyetje të gjata.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë e di se  
15 dhe ju e dini, i nderuar Gjykatës, se në çështje që përfshijnë  
16 më shumë të akuzuar ndodhin gjëra të tilla ku ka domethënë  
17 mbivendosje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, nuk do  
19 ketë marrje në pyetje të stilit komando apo jo?

20 Z. KEHOE: [Përkthim] E kam bërë këtë në të kaluarën, i  
21 nderuar Gjykatës, dhe jemi të njohur me këtë koncept.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Urdhëroni z.  
23 Emmerson.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes]  
25 Shkurtimisht, për sa i përket Mbrojtjes së Veselit, ka vetëm

1 një dëshmitar nga 40 të parët që mendoj se do të na marrë më  
2 shumë kohë për sa u përket pyetjeve të Mbrojtjes.

3 Ky është një dëshmitar që ka dëshmuar në më shumë çështje  
4 gjyqësore dhe është marrë në pyetje në shumë procese. Nuk kam  
5 nevojë që ta përmend emrin. Nuk është dëshmitar i mbrojtur. Ka  
6 të bëjë me organizimin e brendshëm të UÇK-së dhe do të  
7 dëshmojë për çështje që janë të natyrës dhe rëndësisë së  
8 veçantë për këtë proces gjyqësor.

9 Unë personalisht mendoj dhe ju me siguri e dini nga  
10 praktika në Tribunalin për ish-Jugosllavinë se pritshmëritë  
11 për kohën maksimale që do të duhen nuk mund të jenë shumë  
12 reale, varen nga ajo që, domethënë indikacioni që japin palët,  
13 Prokuroria ose Mbrojtja, sesa kohë që iu duhet dhe mund të  
14 ndodhë që t'ju duhet edhe më shumë kohë. Ky është një opsion  
15 që marrin parasysht të gjitha palët, duke përfshirë edhe palën  
16 që merr në pyetje dëshmitarin e palës kundërshtare.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faji im. Nuk  
18 e kisha mikrofonin lëshuar.

19 Ju faleminderit për parashtrimet. Do t'i diskutojmë këto  
20 dhe do të vazhdojmë diskutimet. Nuk kemi marrë vendim hë për  
21 hë se do t'i kufizojmë pyetjet e Mbrojtjes. Po thjesht për të  
22 pasur ide sesa kohë do t'ju duhet.

23 Z. Young, a keni diçka për të shtuar?

24 Z. YOUNG: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të shtuar.

25 Faleminderit.

1 Z. BAIESU: Z. Ellis do të përgjigjet në lidhje me këtë.

2 Z. ELLIS: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nga 40  
3 dëshmitarët e parë ka një grup për të cilët mendoj se  
4 kundërpyetjet tona do të jenë relativisht të shkurtra dhe nuk  
5 do të na duhet shumë kohë.

6 Dëgjuam nga ju për bashkëpunimin dhe sigurisht që ne nuk  
7 synojmë t'i parashtrojmë të njëjtat pyetje që tashmë janë  
8 parashtruar nga një ekip tjetër i Mbrojtjes.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Vetëm edhe një gjë sa për t'ju bërë  
10 me dije.

11 Me lejen tuaj mund të ndryshojmë radhitjen e  
12 kundërpyetjeve për shembull në qoftë se një dëshmitar, dëshmia  
13 e tij ka të bëjë më shumë me një të akuzuar, atëherë ekipet  
14 mund t'ia përshtatin kohën, t'i ndajnë kohët e marrjes në  
15 pyetje ndërmjet vetes.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. Laws, po ta bëj edhe ty pyetjen e përgjithshme. I keni  
18 parë 40 dëshmitarët e parë. Me siguri që e keni shqyrtuar atë  
19 listë, a mund të na jepni një kohë të përafërt sa do t'ju  
20 duhet pra kohë për t'i marrë këta njerëz në pyetje në qoftë se  
21 do t'i merrni në pyetje?

22 Z. LAWS: [Përkthim] Shumë kohë të kufizuar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
24 një përgjigje e shkëlqyeshme.

25 Edhe një pyetje për ju, z. Laws. A keni ndërmend që të

1 dorëzoni një dosje paraprake në këtë çështje gjyqësore?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Është pothuajse 12.00. Mirë e kemi bërë llogarinë. Do të  
5 bëjmë tani pushim deri në orën 12.30. Mbas pushimit do të  
6 japim disa urdhra të shkurtër dhe do ta diskutojmë çështjen e  
7 kërkesës së seancës private në atë kohë.

8 --- Pauza fillon në orën 11.52

9 --- Seanca rifillon në orën 12.30

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni, ju  
11 lutem.

12 Pikë së pari. Do të trajtojmë kërkesën sa i takon  
13 seancave private për mbrojtjen e dëshmitarëve në këtë moment,  
14 kështu që Sekretarja e Gjykatës, ju lutem na nxirrni tashmë në  
15 seancë private.

16 [Seancë private]

17 [Seancë private teksti i fshirë]

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi sërish në seancë  
2 publike.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emerson,  
4 kur dalim në seancë private ju nuk keni mundësi të na dëgjoni  
5 në Zoom. Atëherë, çfarë do bëjmë ne? Besoj se ne mund t'ju  
6 dëgjojmë ju në fakt, thjesht ju nuk na dëgjoni ne. A ta kam  
7 kuptuar siç duhet?

8 Fatkeqësisht, as ju e as ne nuk e dëgjojmë dot njëri-  
9 tjetrin. A ke ndonjë person nga grupi që mund të bëjë  
10 parashtrimet?

11 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo  
12 saktësisht. Por mund t'ju them se mund t'i bëj parashtrimet pa  
13 iu referuar, se unë nuk e di identitetin e dëshmitarit në  
14 fakt, dëshmitarit në fjalë dhe nuk kam pse e përmend dhe  
15 renditjen numerike të dëshmitarit dhe as nuk kam nevojë të  
16 përmend ndonjë detaj sa i takon përmbajtjes së provave. Pra,  
17 ju thashë, unë në fakt nuk do bëj asnjë koment lidhur me  
18 dëshmitarin, vetë dëshmitarit. Por thjesht për faktin se  
19 çështje për të cilën ne ju kemi tërhequr vëmendjen --

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se  
21 nuk ka ndonjë kundërshtim për propozimin tuaj, atëherë z.  
22 Halling.

23 Z. HALLING [Përkthim] Në konferencën e fundit, pati një  
24 problem të ngjashëm që e ngriti Z. Emerson. Na u desh të  
25 nxirrnim urdhra për redakte. Tha që do bëhet publike, por në

1 një version në fakt me shkrim, të versionit të redaktuar  
2 publik, ku ishte e nevojshme të riklasifikonim për konferencën  
3 tjetër. Ky është Vendimi F01150.

4 Nuk duam t'i themi z. Emmerson që të mos e bëjë  
5 parashtrimin, por të lutem, është më mirë që ta bëjë këtë me  
6 shkrim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk do jetë  
8 shumë e gjatë.

9 Atëherë z. Emmerson, keni ju lutem kujdes.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Atë do të  
11 bëj dhe do flas më ngadalë, në mënyrë në qoftë se ka  
12 kundërshtime, t'i ngremë këto kundërshtime teksa jam duke  
13 folur.

14 Sikurse thatë edhe ju më herët, i nderuar Gjykatës, është  
15 një dëshmitar i cili prek ndjeshëm, apo ka shumë, në fakt,  
16 redaktime, në aktakuzë për këtë dëshmitar. Dhe provat  
17 mbështetëse për këtë dëshmitar janë po ashtu shumë, shumë të  
18 redaktuara, sa i takon pjesës së Mbrojtjes. Tani, meqenëse  
19 redaktimet në prova përkojnë me pothuajse të tëra redaktimet  
20 në aktakuzë dhe nuk është çudi të them tani se dëshmitari  
21 është i vetmi ose dëshmitari kryesor që flet për këtë pikë.

22 Ne nuk e dimë çfarë është kjo pikë, po çfarë dimë ne, nga  
23 ç'ka është nxjerrë deri tani, është një vendim i  
24 drejtpërdrejtë kundrejt dy të akuzuarve. Njëri syresh është  
25 klienti im. Ju e keni lexuar dosjen para gjyqësore dhe i keni

1 kuptuar, përfshirë edhe disa nga parashtrimet në materialet që  
2 ju janë kaluar.

3 Sa i takon këtij dëshmitari, ka shumë prova të tjera të  
4 drejtpërdrejta sa i takon pjesëmarrjes së z. Veseli në ndonjë  
5 nga ngjarjet që renditen në aktakuzë. Ky është dëshmitari i  
6 rëndësishëm. Ky është një dëshmitar që në vartësi të asaj që  
7 pretendon ky, është një dëshmitar, që Mbrojtja duhet  
8 përgatitur pra, për këtë dëshmitar, në varësi të asaj që thotë  
9 ky dëshmitar.

10 Ne nuk e dimë datën, nuk e dimë as vendin dhe nuk i dimë  
11 as detajet lidhur me këtë pretendim të ngritur tani.

12 Shpresoj të jetë dhe në fakt e dukshme kjo, të jetë  
13 kuptuar që ky është një dëshmitar ku ndërmarëdhënia mes  
14 aspekteve të ndryshme që janë diskutuar në të shkuarën në këtë  
15 seancën e paradites, janë aspekte që duhen marrë parasysh sa i  
16 takon implikimeve që sjell ky dëshmitar specifik. Edhe më  
17 duhet t'ju them, kjo është e vetmja fushë lidhur me një  
18 dëshmitar specifik, ku korniza që keni propozuar ju,  
19 dëshmitarë, sa i takon nxjerrjes së materialeve, mund të  
20 shkaktojë një problem, mund të përbëjë problem. Sidomos nëse  
21 gjykimi fillon më 1 ose në fillim të marsit, sepse me këtë  
22 dëshmitar kaq të rëndësishëm për një nga të akuzuarit, sepse  
23 një pikë në aktakuzë është e mbështetur pikërisht në këtë  
24 dëshmitar, se edhe vetë pika është e redaktuar, është e qartë  
25 se është e pamundur për ne që ta dimë me siguri që një natyrë

1 e tillë sigurisht kërkon fokus të mëtejshëm sa i takon hetimit  
2 që duhet të bëjmë lidhur me këtë.

3 Tani, për momentin, është një nga dëshmitarët që bën  
4 pjesë në kategorinë e dëshmitarit, informacioni i të cilit do  
5 të nxirret 30 ditë para se të jap dëshminë, dhe jo 30 ditë  
6 para fillimit të gjykimit. Dhe, tani, çfarë do të ndodhë në  
7 mes të gjykimit? Do vendosemi ne një vështirësi të  
8 jashtëzakonshme si Mbrojtje, dhe mund të na çojë në ndonjë  
9 situatë ku do të na duhet t'i kërkojmë Trupit Gjykses ta  
10 ndërpresim seancën, sepse do të na duhet në fakt që të hetojmë  
11 siç duhet këtë dëshmitar. Nuk është thjesht një pikë nga shumë  
12 të tjera, por është e vetmja pikë ku me gjasë ka prova që  
13 përfshijnë drejtpërdrejtë kryerjen e krimit, siç pretendohet  
14 kundër z. Veseli.

15 Pra, në këtë situatë që jemi, normalisht do të  
16 pretendonim të kishim të paktën dy muaj që të hetonim  
17 dëshmitarin e kësaj natyre, kaq i rëndësishëm, apo të paktën  
18 të hetojmë pikën që është ngritur, apo nëse ka çështje alibie,  
19 të kuptojë kur ka ndodhur diçka e parashtruar aty, dhe të  
20 gjejmë dëshmitarë të tjerë që mbase do të kundërshtojnë këtë  
21 pretendim. Aktualisht, Mbrojtja i çoi një email Prokurorisë  
22 para dy ditësh, ku bëri me dije lidhur me këtë dëshmitar se do  
23 të dëshironin që të bëhet një ndryshim i masave mbrojtëse, në  
24 mënyrë që ne këtë dëshmitar, dhe kjo ishte oferta jonë në  
25 fakt, ta kishim 90 ditë përpara fillimit të gjykimit. Nuk po i



1 kritikoj, por përgjigja ishte që baza për masat mbrojtëse  
2 mbetet siç është, mbetet në fuqi, përkrah faktit që në fakt  
3 tani dosja i ka kaluar Trupit Gjykses, çështja i ka kaluar  
4 Trupit Gjykses dhe çdo disavantazh që sjell kjo për Mbrojtjen,  
5 duke mos pasur kohën e mjaftueshme për të hetuar, mund të  
6 zbutet duke e thirrur këtë dëshmitar qysh në fazën e hershme  
7 të gjykimit, pra mund të jetë një nga dëshmitarët e parë. Ky  
8 ishte sugjerimi, pra, që e bëtë edhe ju më herët, në fakt, i  
9 nderuar Gjykatës. Dhe më pas çfarë sjell kjo? Na çon në një  
10 situatë që nuk do t'i kishim provat as 30 ditë para gjykimit,  
11 po diçka -- se do ketë deklaratat hyrëse fillimisht dhe pastaj  
12 mund edhe se mund të mos fillojmë me dëshmitarin e parë, por  
13 ama në thelb është më pak se 30 ditë përpara gjykimit. Sepse  
14 ne të gjithë tani po përgatitemi për gjykimin dhe për  
15 deklaratat hyrëse. Nëse do të ishte ndonjë dëshmitar tjetër,  
16 dhe do të ishte thjesht çështje programimi apo fleksibiliteti,  
17 për mënyrën sesi do të trajtohet, kuptohet, atëherë unë do të  
18 gjeja një zgjidhje praktike për ndonjë dëshmitar tjetër, por  
19 ky nuk është një dëshmitar i zakonshëm, por është një  
20 dëshmitar që sipas Prokurorisë, ky pretendon pjesëmarrjen e z.  
21 Veseli në atë që është paraqitur në aktakuze.

22 Dhe ndërlikimet mund të jenë shumë të gjera, ne e dimë,  
23 dhe bazuar në parashtrimet që bëri Prokuroria sot paradite,  
24 dhe e bëri të qartë se ky është një dëshmitar shumë i  
25 mbrojtur, pra konsiderohet si një dëshmitar shumë i

1 rëndësishëm, të paktën unë kështu e kuptova. Të paktën për  
2 provat e Prokurorisë, ky është shumë i rëndësishëm, që fakti  
3 lidhet pikërisht me atë që po propozoj unë. Sa i rëndësishëm  
4 është ky dëshmitar dhe sa e rëndësishme është që Mbrojtja të  
5 ketë mundësinë të kryejë hetimet që janë të nevojshme për të  
6 zbuluar ose për të parë cilat janë pretendimet që janë  
7 ngritur.

8 Pra ky është problemi. Zgjidhjet e ndryshme -- mua më  
9 duket sikur ka tre zgjidhje në fakt. Disa janë formuluar në  
10 mënyrë shumë të përgjithshme, por e para, të afrojmë, datën e  
11 nxjerrjes së materialeve. Në vend që të themi do të nxirren 30  
12 ditë para fillimit të gjykimit, kjo na çon, i bie që të jetë  
13 fillimi i shkurtit, në qoftë se gjykimi fillon në fillim të  
14 marsit dhe nuk zgjidhet problemi. Zgjidhja e dytë do të ishte  
15 të shtynim datën e gjykimit për në fund të marsit, që do të  
16 thotë, unë në fakt e përmenda edhe më herët, dhe bëj lidhjen e  
17 problemit që ngrita më herët, sepse nëse do të ishte fundi i  
18 marsit si fillimi i gjykimit, do të kishim marsin dhe  
19 shkurtin. Nëse ju do të mbanit siç është aktualisht datën për  
20 nxjerrjen e informacionit.

21 Dhe alternativa e tretë e mundshme dhe ju e përmendët, i  
22 nderuar Gjykatës, pak më herët, është ta fillojmë formalisht  
23 gjykimin me deklaratat hyrëse, dhe pastaj të bëjmë një  
24 shkëputje sa i takon marrjes së provave, në mënyrë -- por nëse  
25 lemë tre javë në mes, do të jetë e vështirë pastaj që të

1 marrim udhëzimet, do të jetë e vështirë të shkojmë në Kosovë,  
2 është e vështirë që të intervistojmë dëshmitarin dhe ky është  
3 një nga dëshmitarët me të cilin synon edhe të fillojë  
4 Prokuroria paraqitjen e provave të veta.

5 Tani nuk po ju marr më shumë kohë, por ky është problemi  
6 në thelb. Reagimi i ZPS-së ndaj alternativës së tretë ishte  
7 që: jo, ata dëshirojnë që deklaratat hyrëse të vijojnë  
8 menjëherë, të vazhdojmë menjëherë me paraqitjen e provave. Ky  
9 është qëndrimi i tyre lidhur me këtë. Po ashtu, nuk e pranojnë  
10 zgjidhjen e nxjerrjes së informacionit përpara ndryshimit të  
11 masave mbrojtës. Pra që të thonë që po, mund të nxirret në  
12 fillim të janarit në mënyrë që të kemi kohë. Dhe qëndrimi i  
13 Prokurorisë është që, po, ne mund ta fillojmë gjykimin në  
14 mars.

15 Tani, lidhur me këtë, është rrezik sepse kjo na pengon  
16 dhe nuk do trajtojmë dot atë që mendojmë që është një  
17 dëshmitar jashtëzakonisht i rëndësishëm, qysh në fillim të  
18 gjykimit, pa e hetuar siç duhet këtë dëshmitar.

19 [Trupi Gjykses këshillohet]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka nga ana  
21 juaj, Z. Emmerson?

22 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po, çdo  
23 njëherë nga këto tre alternativa, z. Gjykatës.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më lejoni  
25 t'ju bëj një pyetje Prokurorisë, ju e përmendët më herët. E

1 dimë ne kur do synoni ta thërrisni këtë dëshmitar? Nuk e  
2 shtyjmë dot pak këtë, në mënyrë që t'ju japim mundësinë  
3 Mbrojtjes që të përgatitet? Se herët a vonë do ta nxirrni  
4 emrin e këtij dëshmitari. Unë e shoh si zgjidhjen më të lehtë,  
5 mos të jetë nga dëshmitarët e parë, të paktën jo tre muajt e  
6 parë të dëshmive mbase.

7 Z. HALLING [Përkthim] Një nga propozimet e z. Emmersonit  
8 do të funksionin. Paraprakisht, do të falënderoj z. Emmerson.  
9 Ai e përshkroi në mënyrë të përgjithshme dëshmitarin, e  
10 vlerësojmë këtë gjë. Kjo është një nga 40 dëshmitarët kryesorë  
11 në rendin tonë.

12 Nga ajo që diskutuam para pushimit, nuk duket sikur është  
13 synimi juaj, i nderuar Gjykatës, që më 30 janar të japim të  
14 gjitha dokumentet me më pak redaktime, ndër të tjera edhe për  
15 dëshmitarët që duhet të nxjerrin informacionin 30 ditë para  
16 dëshmisë.

17 Kur thotë ta afrojmë dhënien e dëshmisë, pra në vend që  
18 të ruajmë afatin 30 ditë para fillimit të gjykimit, në fakt  
19 kjo është diçka që do të mbulohej edhe nga urdhri juaj.

20 Ne mund ta pranojmë këtë propozim. E vetmja gjë që duam  
21 të përmendim është paragrafi i redaktuar në aktakuzë që është  
22 diskutuar. Nuk është i veti dëshmitar, për atë paragraf të  
23 aktakuzës. Por edhe aktakuza do t'ju vendoset në dispozicion  
24 në të njëjtën ditë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt ka

1 edhe një problem. Ne po themi 30 ditë, por ai po thotë se  
2 është e vështirë 30 ditë. Ky dëshmitar a duhet patjetër që të  
3 japë dëshmi qysh në fillim të gjykimit?

4 Z. HALLING [Përkthim] Ne mendojmë se një nga arsyet pse  
5 ky dëshmitar ka nevojë për këto masa mbrojtëse është se është  
6 i rrezikuar nga ndërhyrjet. Është shumë e rëndësishme që t'i  
7 dëgjoni provat e këtij dëshmitari dhe ne synojmë që ta  
8 thërrasim qysh në fillim të gjykimit, të nderuar Gjykatës, që  
9 të dëgjoni rrëfimin e tij, versionin e tij.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson?

11 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Tani meraku  
12 im, pse duhet ta thërrasim qysh në fillim të gjykimit, 30 ditë  
13 në fakt, ndërkohë që po përgatitemi për deklaratat hyrëse dhe  
14 për dëshmitarët e tjerë. Por gjithashtu, nuk po e kritikoj,  
15 por pasoja, ose ajo që përpiqet të bëjë Prokuroria, është të  
16 përdori kohën më të shkurtër të mundshme, për shkak se duan të  
17 shmangin ndërhyrjet e mundshme ndaj këtij dëshmitari. Nuk mund  
18 të themi asgjë me vlerë për këtë, se ne nuk dimë fare çfarë  
19 pretendimi është ngritur. Por meraku im është se zgjidhja që  
20 ofron Prokuroria synon, në një farë mënyrë, ta vendosin në një  
21 pozicion që të kemi kohën më të pakët të mundshme për të  
22 hetuar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pak e  
24 padrejtë, po e kuptoj se çfarë doni të thoni.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ne duhet ta

1 kemi informacionin, pra duket sikur duhet ta japim këtë  
2 informacion sa më afër fillimit të dëshmisë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.  
4 atëherë ju inkurajoj të diskutoni me njëri-tjetrin sepse më  
5 duket sikur ka disa zgjidhje që mund t'i shqyrtoni më tej.  
6 Nëse nuk e bëni dot ju, atëherë do të vendosim ne.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po janë tre  
8 zgjidhje dhe do t'i diskutojmë më tej.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. Kehoe, temë tjetër apo e njëjta gjë?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Temë tjetër.

12 Unë besoj, se bazuar në diskutimin e kësaj teme që kemi  
13 pasur edhe me Gjykatësin e Procedurës Paraprake, mbase duhet  
14 të kalojmë në seancë private ose në seancë të mbyllur.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, z.  
16 Ellis, nuk do të keni mundësi që ta ndiqni më seancën.

17 z. Alagendra, a e kuptoni edhe ju që nuk do të mundeni ta  
18 ndiqni më seancën? Atëherë do të kalojmë në seancë private.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21 [Seancë e hapur]

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë

23 publike.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Gjyqtari Mettraux kishte një pyetje për z. Halling.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj që është z.  
2 Halling. Për ZPS-në, për Prokurorinë bëhet fjalë.  
3 z. Kehoe ndoshta nuk e pranon se lexon me shpejtësi të  
4 madhe por, ndoshta ka të drejtë kur thotë që 46.000 faqe  
5 materiale që do të nxirren janë të shumta për çdo individ dhe  
6 nuk lexohen dot për një periudhë të shkurtër kohore.  
7 Pyetja që kam unë është: a do të ishit në gjendje të  
8 tregoni kur e nxirrni materialin, pra një muaj përpara  
9 fillimit të gjykimit, cilat pjesë të këtij materiali janë të  
10 lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me 40 dëshmitarët e parë?  
11 Dhe unë kam parasysh a keni ndonjë dëshmi, apo prova  
12 materiale, të cilat ju dëshironi t'i paraqisni mes këtyre  
13 dëshmitarëve. Pra, bëhet fjalë për lehtësimin e punës së palës  
14 së Mbrojtjes, dhe të z. Laws. Pra, me anë të identifikimit të  
15 materialit, të cilave do t'u kushtohet vëmendja fillestare.  
16 E dyta, ka të bëjë me dëshmitarin e përmendur para një  
17 çasti nga z. Kehoe. Dhe pyetja është a ka ndonjë vështirësi që  
18 ky dëshmitar të mund të thirret të vijë të japë dëshmi nga  
19 fundi i grupit të parë të dëshmitarëve dhe jo në fillim. Pra  
20 që në qoftë se ekziston nevoja për ta marrë në pyetje këtë  
21 dëshmitar, në varësi të vendimit që nxjerr Gjykata e Apelit,  
22 ju mundet të krijoni mundësinë që ky dëshmitar të mund të  
23 thirret në një periudhë më të vonshme.  
24 Z. HALLING [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës,  
25 dhe po i jap përgjigje dhe shpresoj t'i përgjigjem siç duhet.

1 Për sa i përket 46.000 faqeve, këto materiale janë  
2 paraqitur në *Legal Workflow*, në rendin e duhur, dhe kërkesë e  
3 çdo kërkesë, apo mocion që do të bëhet në bazë të rregullës  
4 154 për këtë dëshmitar, do të bëhet përpara fillimit të  
5 gjykimit dhe aty do të identifikohen të gjitha deklaratat dhe  
6 provat materiale të shoqëruara me to, të cilat do t kërkojmë  
7 të pranohen si prova materiale, në bazë të këtij Rregulli.

8 Për sa i përket dëshmitarit të paraqitur nga z. Emmerson,  
9 arsyeja që ne kemi thënë është e rëndësishme për sigurinë e  
10 tij, që ai të mundë të vijë për të dhënë dëshmi shumë afër 30  
11 ditëve që kemi në dispozicion. Pra, në 30 në afërsi të  
12 pranimi të gjykimit, është diçka që ne mund ta pranoni.

13 Në qoftë se kur të marrim materialet më pak të  
14 redaktuara, pala mbrojtëse dëshiron që të bëjë një kërkesë për  
15 ta lëvizur radhën e këtij dëshmitari, ne do ta dëgjojmë këtë.  
16 Kjo është hipotetike. Në këtë moment ne duam që këto çështje  
17 të ekzistojnë para se të japim përgjigje e duhur.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë  
20 gjë tjetër përpara se të kalojmë tek urdhrat gojorë?

21 Mikrofonin.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Ka të bëjë me çështjen e lirimit të  
23 para fillimit të gjykimit. Klientët tanë kanë qenë në  
24 paraburgim për një kohë të gjatë. Ne mund të lirojmë ata që të  
25 shkojnë në shtëpi për një periudhë të caktuar. Një nga masat



1 është paraqitur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Bëhet  
2 fjalë për një monitorim 24 orësh në vende të ndryshme apo në  
3 vend të tretë.

4 E kemi bërë këtë kërkesë përpara Gjykatësit të Procedurës  
5 Paraprake dhe e kemi marrë edhe njoftimin e ZPS-së. Është e  
6 njëjta gjë dhe në fakt kjo çështje është në lidhje me atë që  
7 përmendëm më herët për dëshmitarët e mëparshëm. Megjithatë, i  
8 nderuar Gjykatës, unë do t'ju thosha që ky është një propozim  
9 që ju kërkoj juve dhe do t'ju kërkoja një farë udhëzimi sesi  
10 ta ngremë këtë në mënyrë më zyrtare përpara jush.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rishikimet  
12 periodike vazhdojnë dhe ne do t'i shqyrtojmë në mënyrë shumë  
13 të kujdesshme, siç po e bëjmë me dy prej tyre. Ne do të  
14 nxjerrim vendimet tona përkatëse, i kemi marrë parasysh të  
15 gjitha sugjerimet tuaja dhe do tani do të vazhdojmë të  
16 nxjerrim urdhrat tanë gojorë.

17 Z. LAW: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Unë do të ngre një  
18 çështje që ka të bëjë me viktimat në këtë çështje.

19 Deri më sot, 53 është numri i viktimave që është pranuar  
20 që do të jenë pjesë e këtij procesi. Siç e dini, i nderuar  
21 Gjykatës, janë pesë raporte të Zyrës Administrative që ende  
22 mbeten për t'u shqyrtuar. Më i hershmi është ai raporti i  
23 gjashtë, më 18 gusht të këtij viti.

24 Po të marrim në tërësi numrin e viktimave të cilat janë  
25 rekomanduar për t'u pranuar si përfaqësues dhe duke harruar

1 edhe ata që nuk janë pranuar, numri është 84 tërësisht. Pra,  
2 janë 84 numri i viktimave të cilët do të marrin pjesë në këtë  
3 gjykim dhe është një shifër mjaft e lartë.

4 Ne jemi të ndërgjegjshëm që koha që kanë në dispozicion,  
5 të nderuar Gjykatës, është e vyer dhe ka shumë gjëra që duhet  
6 të trajtojnë por duam të nënvizionim këtë çështje dhe disa  
7 çështje.

8 Së pari, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vendimin e  
9 tij këtë javë e ka miratuar kërkesën e bërë nga Mbrojtja e  
10 Thaçit për të nxjerrë dëshmitarë me status të dyfishtë, pasi  
11 kjo do t'u krijonte atyre mundësinë për t'u përgatitur. Ne  
12 duam të dimë, dhe ata duhet ta dinë këtë çështje, përpara se  
13 të fillojë gjyqi, pra këto janë ato raportet të cilat nuk  
14 nxjerrë ende dhe mbeten pa u shqyrtuar.

15 Dhe e dyta është e thjeshtë dhe bëhet fjalë për viktimat  
16 të cilat janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë  
17 kërkesë. Dhe ata vetë duan ta dinë një gjë të tillë dhe po të  
18 më lejoni, po e përshkruaj se për çfarë bëhet fjalë.

19 Unë dua që këtë çështje ta ngrej këtu dhe të ngrihet sa  
20 më lartë numri në rendin e ditës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
22 ne e dimë këtë shifër dhe e kemi diskutuar në mënyrë paraprake  
23 këtë çështje gjatë ditës së djeshme dhe ne kemi kërkuar në  
24 mënyrë paraprake një metodë për ta trajtuar këtë çështje dhe  
25 do t'ju japim vendimin sa më shpejtë që të jetë e mundur.

1 Z. LAW: [Përkthim] Faleminderit. Jam mirënjohës.

2 Urdhri i parë, mbi gjuhën e punës.

3 Në përputhje me paragrafin 8(3), Trupi Gjykues thotë që  
4 gjuha angleze do të jetë gjuha e punës. Palët dhe  
5 pjesëmarrësit do të duhet që të zbatojnë udhëzimet e vendimit  
6 të Gjykatës e Procedurës Paraprake lidhur me gjuhën e punës,  
7 të datës 11 nëntor të vitit 2020.

8 E dyta, ka të bëjë me një propozim lidhur me zhvillimin e  
9 gjykimit. Aktualisht është një projekt-urdhër i cili është në  
10 përfundim e sipër dhe në përputhje me rregullën 116(3),  
11 projekti i urdhrit tonë mbi zhvillimin e gjyqit do t'i  
12 qarkullohet palëve sa më shpejt që të jetë e mundur, sapo ta  
13 përfundojë këtë Trupi Gjykues dhe kjo do t'ju dërgohet ju për  
14 ta shqyrtuar dhe për të bërë parashtrimet tuaja.

15 Palët dhe Mbrojtja e Viktimave ftohen që të bëjnë  
16 parashtrimet e tyre lidhur me këtë projekt urdhër deri më  
17 datën 13 janar në orën 16.00. Nuk presim që ju të bëni koment  
18 për çdo paragraf, por kërkojmë që ju të përqendrohemi në  
19 ndonjë çështje të diskutueshme.

20 Palët, si dhe Mbrojtja e Viktimave, do të identifikojnë  
21 në mënyrë të posaçme, e para nëse kanë ndonjë kundërshtim  
22 lidhur me propozimet e bëra në projektet e urdhrit mbi  
23 zhvillimin e gjykimit dhe e dyta, bazën dhe autoritetin ligjor  
24 për të mbështetur kundërshtimet e tyre. Nuk do të ketë  
25 përgjigje. Trupi Gjykues do të diskutojë çështjet e mbetura me

1 palët, në qoftë se është e nevojshme përpara se ta nxjerrë  
2 urdhrin.

3 Pra data është 13 janar. 13 janar, pra.

4 Urdhri i tretë gojor.

5 Trupi Gjykues mbetet i bindur që data 1 mars është data  
6 më e përshtatshme për të filluar gjykimin. Megjithatë, urdhri  
7 pasues ka të bëjë me shqetësimin e paraqitur nga Mbrojtja, për  
8 sa i përket kësaj. ZPS-ja kërkohet që t'i japë Panelit brenda  
9 1 shkurtit të vitit 2023 në orën 16.00 listën e 12  
10 dëshmitarëve të parë të cilët do të dëgjohen gjatë dy javëve  
11 të para apo gjatë 3 javëve të para, në qoftë se numri është në  
12 i madh dhe do të paraqesin emrin dhe pseudonimin e tyre,  
13 radhën e paraqitjes, deklaratën e mëparshme apo transkriptimin  
14 e dëshmisë së tyre, nëse dëshmitarët që ZPS-ja do të paraqesë  
15 do të japin dëshmi gojore pjesërisht apo tërësisht. Këtu, edhe  
16 nëse ZPS-ja kërkon që të paraqesë dëshmitë e tyre dhe  
17 transkriptimin e provave, në bazë të rregullës 154; pesë,  
18 çështjet, faktet dhe rrethanat mbi të cilat do të merren në  
19 pyetje; gjashtë, kohën për pyetjet kryesore; shtatë,  
20 dokumentet dhe provat materiale që ZPS-ja propozon të përdorë  
21 me secilin prej dëshmitarëve në bazë të numrit rendor; dhe  
22 tetë, masat mbrojtëse të urdhëruara për dëshmitarët dhe të  
23 gjitha masat e tjera që kanë të bëjnë me ndryshimin e këtyre  
24 urdhrave.

25 Brenda 17 shkurtit, të vitit 2023, në orën 16.00 palët

1 Mbrojtëse dhe Mbrojtja e Viktimave urdhërohen që ta njoftojnë  
2 Trupin Gjykses dhe palët pjesëmarrëse të tjera, lidhur me  
3 dëshmitarët e ZPS-së: e para, nëse dëshirojnë të bëjnë kundër  
4 pyetje dëshmitarëve, dhe nëse po, sa kohë do të zgjasë. Dy,  
5 nëse kundërshtojnë pranimin e dëshmisë së dëshmitarit në bazë  
6 të rregullës 154, në qoftë se ata e ofrojnë një gjë të tillë  
7 dhe arsyen se përse e kundërshtojnë këtë. Tre, nëse  
8 kundërshtojnë pranimin e ndonjë dokumenteve, ose të tërë  
9 dokumenteve që propozon ZPS-ja të shfrytëzojë me atë  
10 dëshmitar, dhe arsyet se përse bëhet ky kundërshtim.

11 Ekipet e Mbrojtjes do të konsultohen me njëra-tjetrën dhe  
12 do të diskutojnë fushë veprimin dhe natyrën e kundër pyetjeve,  
13 me qëllim që të mos ketë pyetje të përsëritura dhe të bien  
14 dakord që një palë mbrojtëse të mund të bëjë kundër pyetje të  
15 një dëshmitari apo shumicën e tij. Ky nuk është një urdhër,  
16 por është një sugjerim.

17 Në të njëjtën ditë Mbrojtja e Viktimave do ta njoftojë  
18 Trupin Gjykses dhe palët pjesëmarrëse për dëshmitarët që  
19 dëshiron të marrë në kundërpyetje, duke dhënë një përshkrim të  
20 përgjithshëm të çështjeve dhe të fushës së dëshmisë, mbi të  
21 cilën duan që të bëjnë pyetje.

22 Trupi Gjykses vëren më tej se pala paraqitëse ka  
23 përgjegjësinë për të bërë të mundur që përfundimin e dëshmisë  
24 së një dëshmitari dhe në qoftë se gjithmonë një dëshmitar  
25 tjetër të gatshëm. Në qoftë se një dëshmitar i propozuar nuk

1 është i gatshëm të japë dëshminë në kohën e duhur, apo në  
2 qoftë se nuk ka kundërpyetje, apo në qoftë se kundërpyetjet  
3 bëhen më shpejt, përfundojnë më shpejt sesa duhet, pala  
4 paraqitëse apo thirrëse duhet të bëjë të mundur që dëshmitari  
5 pasues të mund të vijë të japë dëshmi, me qëllim që të mos  
6 ketë vonim të procesit penal.

7 Urdhri i katërt.

8 Deri më datën 8 shkurt, 2023, ora 16:00 ZPS-ja ftohet që  
9 të paraqesë nëse dëshiron, mocion për dëshmi jo gojore që  
10 bëhen me provat materiale, apo me listën e provave të cilat  
11 dëshiron të shfrytëzojë me 40 dëshmitarët e parë. E dyta,  
12 materiale provë që ZPS-ja mendon se janë të rëndësishëm për të  
13 paraqitur në mënyrë të qartë dhe efektive argumentin e saj në  
14 këtë fazë.

15 ZPS-ja nuk është e detyruar që ta bëjë këtë por, mund ta  
16 bëjë një të tillë, në qoftë se në përputhje me rregullat,  
17 mendon se kjo do të shkurtojë kohën në sallë, e cila do të  
18 ishte koha që do të harxhohej duke pranuar këtë provë. Në  
19 qoftë se bëhet mocion i tillë, apo kërkesë e tillë, ZPS-ja do  
20 të bëjë: e para, të japë një shpjegim të shkurtër të provave  
21 të propozuara që kërkon të pranohen, e dyta, të identifikojë  
22 provat materiale të propozuara që kanë të bëjnë me 12  
23 dëshmitarët e parë, e treta, të paraqesë në mënyrë specifike e  
24 të qartë sesa të lidhura janë provat dhe këtë ta bëjë duke  
25 referuar aktakuzën dhe vlerën provuese të secilës provë, dhe e

1 katërta, të japë tregues të autenticitetit apo vërtetësisë së  
2 provave materiale.

3 Pala Mbrojtëse do të përgjigjet ndaj këtyre kërkesave  
4 brenda 22 shkurtit, 2023, në orën 16.00. Nuk do të ketë  
5 përgjigje.

6 Paneli kërkon që të gjitha këto dosje të parashikuara do  
7 të diskutohen në mënyrë kolegjinale.

8 E pesta: brenda 15 shkurtit 2023 ZPS-ja kërkohet që të  
9 paraqesë mocione lidhur me propozimin e palës mbrojtëse, që të  
10 gjitha materialet e redaktuara të 40 dëshmitarëve të parë do  
11 të duhet të paraqiten dhe të nxirren. Në qoftë se ZPS-ja  
12 kërkon që t'i mbahen ndonjë prej redaktimeve në aktakuzë apo  
13 të mos paraqesë identitetin e provave provuese materiale me 40  
14 dëshmitarët e parë përtej 30 janarit të vitit 2023, ZPS-ja do  
15 të tregojë qartë për secilin prej dëshmitarëve të mbrojtur se  
16 cilat janë arsyet faktike që e justifikojnë këtë gjë. ZPS-ja  
17 do ta shpjegojë këtë se përse ky dëshmitar nuk mund të japë  
18 dëshmi në 30 ditët të para të gjyqit.

19 ZPS-ja do të identifikojë se cilat redaktime duhet të  
20 mbahen për sa i përket publikut.

21 Pala Mbrojtëse kërkohet që të japë përgjigje brenda 20  
22 janarit 2023, dhe nuk do të ketë kundër përgjigje.

23 [Trupi Gjykses këshillohen]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e përsëris  
25 rreshtin e parë mbi masat mbrojtëse, pasi ka një problem në

1 transkriptim.

2 Në 14 janar të vitit 2023, ZPS-ja urdhërohet që të  
3 dorëzojë parashtrimin lidhur me propozimin e Trupit Gjykues  
4 për të urdhëruar heqjen brenda 30 janarit të vitit 2023 e të  
5 gjitha redaktimeve në aktakuzë dhe t'i nxjerrë Mbrojtjes  
6 identitetin e materialet të paredaktuara, prova që kanë të  
7 bëjnë me 40 dëshmitarët e parë. Këtu përfundojnë urdhrat tanë  
8 gojorë.

9 Ne e kemi marrë parasysh kërkesën tuaj për të mos  
10 planifikuar përgjigjet apo asnjë lloj gjatë periudhës së  
11 pushimeve.

12 Ne ju mirëpresim, mirëpresim kontributin që jepni ju  
13 këtu. Ndoshta ka qenë një mëngjes i vështirë, por kemi arritur  
14 mjaft dhe do të vazhdojmë të ecim në këtë mënyrë.

15 Në mënyrë specifike, z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe  
16 z. Krasniqi, faleminderit që ishit të pranishëm sot këtu, e  
17 vlerësojmë praninë tuaj dhe besoj që këtu do të përfundojë kjo  
18 seancë, në qoftë se nuk keni ndonjë gjë tjetër që doni të  
19 ngrini.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] E vetmja gjë që kisha ndërmend të  
21 ngrija është çështja e mocionit për t'i marrë dëshmitarët  
22 jashtë radhës së duhur, për të cilën do të dërgojmë një  
23 mocion.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë mund ta  
25 bëni menjëherë pas përfundimit të pushimit të Gjykatës.



1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

2 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes mbyllet

3 në orën 13.24

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25